



ProCredit Bank Sh.a.
Pasqyrat Financiare sipas Standardeve
Ndërkombëtare të Raportimit Financiar

më 31 Dhjetor 2017



**COSMOS TRANSLATIONS
& EVENTS SH. P.K.**

NIPT: L01731002V

**Rr. «Andon Zako Çajupiu»
P.20/4, Strk.1, Ag.5/6,
Tirana - Albania**

**E-mail: info@cosmos-sh.com
www.cosmos-sh.com**




Përmbajtja

RAPORTI I AUDITUESVE TË PAVARUR	1
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR.....	1
PASQYRA E FITIM HUMBJEVE DHE TË ARDHURAVE PËRMBLEDHËSE	2
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL.....	3
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	4

SHËNIME SHOQËRUESE MBI PASQYRAT FINANCIARE

1. HYRJE	6
2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL.....	6
3. STANDARDE TË REJA, AMENDIME DHE INTERPRETIMET ENDE TË PA MIRATUARA.....	15
4. DEKLARIME TË REJA KONTABËL.....	15
5. GJYKIME KONTABËL KRITIKE DHE BURIMET KRYESORE TË PASIGURISË SË VLERËSIMIT.....	18
6. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR.....	19
7. VLERAT E DREJTA TË INSTRUMENTEVE FINANCIARE.....	38
8. TË ARDHURA NGA INTERESI, NETO.....	40
9. TË ARDHURA NGA KOMISIONET, NETO.....	40
10. TË ARDHURA TË TJERA OPERATIVE, NETO.....	40
11. SHPENZIME TË TJERA OPERATIVE.....	41
12. SHPENZIME PERSONELI.....	41
13. TATIMI MBI FITIMIN.....	41
14. MJETE MONETARE DHE LLOGARI ME BANKËN QENDRORE.....	42
15. HUA DHE PARADHËNIE INSTITUCIONEVE FINANCIARE.....	43
16. HUA DHE PARADHËNIE KLIENTËVE.....	43
17. INSTRUMENTE FINANCIARE TË VENDOSJES.....	44
18. MJETE TË TJERA.....	45
19. INVESTIME NË PRONA.....	46
20. NDËRTESA DHE PAJISJE.....	47
21. AKTIVE AFATGJATA JO-MATERIALE.....	47
22. DETYRIME NDAJ BANKAVE.....	48
23. DETYRIME NDAJ KLIENTËVE.....	48
24. BORXHI I VARUR.....	49
25. DETYRIME TË TJERA.....	49
26. KAPITALI AKSIONER DHE REZERVAT LIGJORE.....	50
27. ANGZHIME DHE TË DREJTA/DETYRIME TË KUSHTËZUARA.....	51
28. TRANSAKSIONE ME PALË TË LIDHURA.....	51
29. NGJARJE PAS DATËS SË RAPORTIMIT.....	51



COSMOS TRANSLATIONS
& EVENTS SH.P.K.

NIPT: L01731002V

Rr.«Andon Zako Çajupi»
P.2004,Shk.1,Ap.516
Tirana - Albania
E-mail: info@cosmos-sh.com
www.cosmos-sh.com



PWC

Raporti i Audituesve të Pavarur

Për aksionerët dhe Këshillin Drejtues të ProCredit Bank Sh.A

Opinion

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare japin, në të gjitha aspektet materiale, një pamje të vërtetë dhe të drejtë për gjendjen financiare të ProCredit Bank Sh.A ("Banka") më datë 31 Dhjetor 2017, dhe për ecurinë financiare të saj, dhe flukset e parasë për ushtrimin e mbyllur, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Ne kemi audituar

Pasqyrat financiare të Bankës përfshijnë:

- Pasqyrën e pozicionit financiar për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017;
- Pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe pasqyrën e të ardhurave të tjera përmbledhëse për vitin ushtrimor të mbyllur;
- Pasqyrën e ndryshimeve në kapital për vitin ushtrimor të mbyllur;
- Pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare për vitin ushtrimor të mbyllur;
- Shënimet shoqëruese të pasqyrave financiare, të cilat përfshijnë përmbledhjen e politikave kontabël.

Bazat për Opinionin tonë

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve përshkruhen më tej në seksionin Përgjegjësitë e Audituesve për Auditimin e Pasqyrave Financiare të raportit tonë. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar jep një bazë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për opinionin tonë.

Pavarësia

Ne veprojmë në mënyrë të pavarur nga Banka në përputhje me Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionistë ("Kodi IESBA"). Ne kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me Kodin IESBA.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe atyre të ngarkuar me Drejtimin për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe për ato kontrole të brendshme, të cilat Drejtimi i përcakton sit ë nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali material të shkaktuara nga mashtrimi ose gabimi.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së bankës për të vazhduar në vijimësi, zbulimin, sipas rastit, të çështjeve që lidhen me vijimësinë dhe përdorimin e bazës kontabël të vijimësisë derisa drejtimi të synojë ose të likuidojë bankën ose të pushojë veprimtaritë e tij, ose të mos ketë asnjë alternativë realiste tjetër përveç kësaj. Të ngarkuarit me drejtimin janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bankës.

Përgjegjësitë e Audituesve për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë sigurimi i një besueshmërie të arsyeshme që pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe nxjerrja e




COSMOS TRANSLATIONS
& EVENTS SH.R.K.

NIPT: L21751002W

Rr. «Andon Zeka» Çirripin
P.2014, bl. 1, q. 2/6
Tiranë, ALBANI

E-mail: info@cosmos-al.com
www.cosmos-al.com



raportit të audituesve që përfshin opinionin tonë. Besueshmëria e arsyeshme nënkupton një nivel më të lartë sigurimi, por nuk përbën garanci për zbulimin e ndonjë anomalie materiale nga një auditim i kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Anomalitë mund të lindin nga mashtrimi apo gabimi dhe konsiderohen si materiale nëse, individualisht ose së bashku, ato në mënyrë të arsyeshme mund të priten të ndikojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, ne japim gjykimin tonë në mënyrë profesionale dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:


- Identifikojmë dhe vlerësojmë riskun e gabimeve materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit të përgjegjshme për këto rreziqe dhe marrim dëshmi të auditimit të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë bazat e opinionit tonë. Rreziku i mos-zbulimit të ndonjë gabimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë se një që rrjedh nga gabimi, duke qenë se mashtrimi mund të përfshijë të fshehta, falsifikim, mosveprime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkeljen e kontrollit të brendshëm.
 - Të kuptuarit e kontrollit të brendshëm të përshtatshëm për auditimin me qëllim hartimin e procedurave të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të bankës.
 - Vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe dhënien e informacioneve të ngjashme shpjeguese të bëra nga drejtimi.
 - Konstatimet mbi përshtatshmërinë e përdorimit nga Drejtimi të bazës kontabël të vijimësisë dhe, në bazë të dëshmive të marra të auditimit, konstatimin nëse ekziston ndonjë pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime të konsiderueshme në aftësinë e bankës për të vazhduar në vijimësi. Nëse ne konkludojmë se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të audituesve për dhënien e informacioneve shpjeguese të lidhura me pasqyrat financiare, ose, në qoftë se zbulimet të tilla janë të papërshtatshme, të ndryshojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në dëshmitë e marra të auditimit deri në datën e raportit të audituesve tanë. Megjithatë ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të bëjnë që Banka të ndalojë vazhdimin e aktiviteteve të saj.
-
- Vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme, strukturës dhe përmbajtjes së pasqyrave financiare, duke përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë transaksionet dhe ngjarjet.
 - Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me drejtimin, midis të tjerave në lidhje me qëllimin e planifikuar, kohën e auditimit dhe konstatimet e rëndësishme të auditimit, duke përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

PricewaterhouseCoopers Audit Sh.p.k
11 maj 2018
Tiranë, Shqipëri

Auditues statutor
Jonid Lamllari



COSMOS TRANSLATIONS
& EVENTS SH.P.K.
NIPT: L01731002V
Pr. «Andon Zako Çajupi»
P.2004, Shk. 1, Ap.5/6
Tirana - Albania
E-mail: info@cosmos.al
www.cosmos.al



Në Lek'000

Shënime	Në Lek'000		In EUR'000		
	2017	2016	2017	2016	
Aktivët					
Mjete monetare dhe llogari me Bankën Qendrore	14	6,710,872	5,839,408	50,477	43,181
Hua dhe paradhënie institucioneve financiare	15	119,326	1,238,954	898	9,162
Instrumente financiare të vendosjes	16	22,779,031	19,894,451	171,335	147,116
Instrumente financiare të vendosjes	17	1,831,349	2,870,306	13,775	21,225
Të drejta tatimore të shtyra	13	64,980	17,358	489	128
Tatimi mbi fitimin e arkëtuar të Korporatës		55,154	42,561	415	315
Mjete të tjera	18	1,287,503	1,835,911	9,684	13,576
Investime në prona	19	92,057	100,979	692	747
Ndërtesa dhe pajisje	20	1,121,939	1,260,292	8,439	9,320
Aktive afatgjata jo-materiale	21	101,601	133,365	764	986
Aktive gjithsej		34,163,812	33,233,585	256,968	245,756
Detyrimet					
Detyrime ndaj bankave	22	2,879,406	141,226	21,658	1,044
Detyrime ndaj klientëve	23	24,046,245	27,302,128	180,867	201,894
Fonde të tjera të marra hua		1,860,486	-	13,994	-
Detyrime të tjera	25	402,656	255,747	3,029	1,891
Borxhi i varur	24	685,905	697,875	5,159	5,161
Detyrime gjithsej		29,874,698	28,396,976	224,707	209,990
Kapitali aksionar					
Kapitali aksionar	26	3,387,148	3,387,148	25,477	25,047
Fitimi i pashpërndarë	26	221,320	757,962	1,706	5,707
Rezerva ligjore	26	708,110	707,672	5,326	5,233
Rezerva e rivlerësimit nga kurset e këmbimit		-	-	(43)	(101)
Rezerva e rivlerësimit për letrat me vlerë të vendosjes	17	(27,464)	(16,173)	(205)	(120)
Totali i Kapitalit Aksionar		4,289,114	4,836,609	32,261	35,766
Totali i Detyrimeve dhe Kapitalit Aksionar		34,163,812	33,233,585	256,968	245,756

Shifrat ekuivalente në Euro paraqiten vetëm për qëllime informimi dhe nuk janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të audituara (referoju shënimit 2 (e)).

Këto pasqyra financiare janë miratuar në Këshillin Ekzekutiv në datën 24 prill 2018 dhe janë nënshkruar në emër të tij nga:

Adela Leka
Zëdhënëse e Këshillit Administrativ

Elvira Tartari
Drejtoresh e Departamentit të Financës




COSMOS TRANSLATIONS
& EVENTS SH.P.K.

NIPT: L01731002V

Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare duhet të lexohet në lidhje me shënimet të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare që paraqiten nga faqa 8 deri në 54.

Rr. "Fjalor Zako Çajupi"
P.2074, Shk.1, Ap.5/6
Tirana - Albania
E-mail: info@cosmos.al.com
www.cosmos.al.com

PASQYRA E FITIM HUMBJEVE DHE TË ARDHURAVE PËRMBLEDHËSE
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor



Shënime	Në LEK'000		Në EUR'000		
	2017	2016	2017	2016	
Të ardhura nga interesat	8	1,340,420	1,631,815	9,993	11,879
Shpenzime për interesat	8	(200,764)	(252,134)	(1,497)	(1,835)
Të ardhura nga interesi, neto		1,139,656	1,379,681	8,496	10,044
Provizionet për humbjet nga kreditë	16	(162,203)	(60,444)	(1,209)	(440)
Të ardhura nga interesi neto pas provizioneve për zhvlerësimin e kredive		977,453	1,319,237	7,287	9,604
Të ardhura nga komisionet	9	268,909	313,388	2,005	2,281
Shpenzime për komisionet	9	(122,934)	(115,539)	(917)	(841)
Të ardhura të tjera operative, neto	10	92,888	132,205	693	890
Të ardhura nga këmbimet valutore duke zbritur humbjet		(30,855)	(5,352)	(230)	(39)
Shpenzime për personelin	12	(424,834)	(453,845)	(3,167)	(3,304)
Shpenzime të tjera operacionale	11	(1,342,461)	(1,160,640)	(10,009)	(8,376)
Fitimi neto përpara tatimit mbi fitimin		(581,834)	29,454	(4,338)	215
Shpenzime për tatimin mbi fitimin /(kredit)	13	45,630	(20,698)	340	(151)
Fitimi për periudhën		(536,204)	8,756	(3,998)	64
Të ardhura të tjera përmbledhëse për periudhën					
<i>Zëra që mund të riklasifikohen në vijim në pasqyrën të ardhurave dhe shpenzimeve:</i>					
Rezerva e rivlerësimit për letrat me vlerë të vendosjes	17	(13,283)	(21,873)	(100)	(162)
Të drejta tatimore të shtyra për rezervën e letrave me vlerë të vendosjes	13	1,992	3,281	15	24
Totali i të ardhurave të tjera përmbledhëse për periudhën, neto		(547,495)	(9,836)	(4,083)	(74)

Shifrat ekuivalente në Euro paraqiten vetëm për qëllime informimi dhe nuk janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të audituara (referoju shënimit 2 (e)).



COSMOS TRANSLATIONS & EVENTS SH.P.K.

NIPT: E01731002V

Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare duhet të lexohet në lidhje me shënimet të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare që paraqiten nga faqa 8 deri në Error! Bookmark not defined..

«Andon Zako Çajupi»
P.20/1, Shk. 1 Ap.5/6
Tirana - Albania
E-mail: info@cosmos-al.com
www.cosmos-al.com

ProCredit Bank Sh.a.
Pasqyrat Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar
më 31 Dhjetor 2017

NË LEK'000	Kapitali aksioner	Rezervat ligjore	Rezerva e rivlerësimit /(Deficit)	Fitimi i pashpërndarë	Totali
Gjendja më 1 Janar 2016	3,387,148	699,829	2,419	917,477	5,006,873
<i>Transaksionet me aksionarët të regjistruara direkt në kapitalin aksionar</i>	-	-	-	(160,428)	(160,428)
<i>Shpërndarja e dividendëve</i>	-	-	-	(160,428)	(160,428)
Totali i transaksioneve me aksionarët të regjistruara direkt në kapitalin aksionar	-	-	-	(160,428)	(160,428)
<i>Totali i të ardhurave të tjera përmbledhëse për periudhën</i>	-	-	-	-	-
<i>Letrat me vlerë të vendosjes</i>	-	-	(21,873)	-	(21,873)
<i>Të drejta tatimore të shtyra për letrat me vlerë të vendosjes</i>	-	-	3,281	-	3,281
<i>Totali i të ardhurave të tjera përmbledhëse për periudhën</i>	-	-	(18,592)	-	(18,592)
<i>Fitimi për periudhën</i>	-	-	-	8,756	8,756
Totali i të ardhurave përmbledhëse për periudhën	-	-	(18,592)	8,756	(9,836)
<i>Përvetësimi i fitimit të mbartur</i>	-	7,843	-	(7,843)	-
Gjendja më 31 Dhjetor 2016	3,387,148	707,672	(16,173)	757,962	4,836,609
<i>Transaksionet me aksionarët të regjistruara direkt në kapitalin aksionar</i>	-	-	-	-	-
<i>Shpërndarja e dividendëve</i>	-	-	-	-	-
Totali i transaksioneve me aksionarët të regjistruara direkt në kapitalin aksionar	-	-	-	-	-
<i>Totali i të ardhurave të tjera përmbledhëse për periudhën</i>	-	-	-	-	-
<i>Letra me vlerë të vendosjes</i>	-	-	(13,283)	-	(13,283)
<i>Të drejta tatimore të shtyra për letrat me vlerë të vendosjes</i>	-	-	1,992	-	1,992
<i>Totali i shpenzimeve përmbledhëse për periudhën</i>	-	-	(11,291)	-	(11,291)
<i>Fitimi për periudhën</i>	-	-	-	(536,204)	(536,204)
Totali i shpenzimeve përmbledhëse për periudhën	-	-	(11,291)	(536,204)	(547,495)
<i>Përvetësimi i fitimit të mbartur</i>	-	438	-	(438)	-
Gjendja më 31 Dhjetor 2017	3,387,148	708,110	(27,464)	221,320	4,289,114

PROCREDIT BANK SH.A.

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor (vazhdim)

	Kapitali aksionar	Rezervat ligjore	Rezerva e rivlerësimit nga kursët e këmbimit (204)	Rezerva e rivlerësimit	Fitim i pashpërndarë	Totali
Në EUR'000						
Gjendja më 1 Janar 2016	24,673	5,098	(204)	18	6,887	36,472
<i>Transaksionet me aksionarët të regjistruara direkt në kapitalin aksionar</i>	-	-	-	-	(1,186)	(1,186)
Shpërndarja e dividendëve	-	-	-	-	(1,186)	(1,186)
Totali i transaksioneve me aksionarët të regjistruara direkt në kapitalin						
<i>Totali i të ardhurave të tjera përmbledhëse për periudhën</i>						
Letrat me vlerë të vendosjes	-	-	-	(162)	-	(162)
Të drejta tatimore të shlyra për letrat me vlerë të vendosjes	-	-	-	24	-	24
Totali i të ardhurave të tjera përmbledhëse për periudhën	-	-	-	(138)	-	(138)
Fitimi për periudhën	-	-	-	-	64	64
Diferenca valutore të rivlerësimit	374	77	103	-	-	554
Totali i të ardhurave të tjera përmbledhëse për periudhën	374	77	103	(138)	64	480
Përvetësimi i fitimit të mbartur	-	58	-	-	(58)	-
Gjendja më 31 Dhjetor 2016	25,047	5,233	(101)	(120)	5,707	35,766
<i>Totali i të ardhurave të tjera përmbledhëse për periudhën</i>						
Letrat me vlerë të vendosjes	-	-	-	(100)	-	(100)
Të drejta tatimore të shlyra për letrat me vlerë të vendosjes	-	-	-	15	-	15
Totali i shpenzimeve përmbledhëse për periudhën	-	-	-	(85)	-	(85)
Fitimi për periudhën	-	-	-	-	(3,998)	(3,998)
Diferenca valutore të rivlerësimit	430	90	58	-	-	578
Totali i shpenzimeve përmbledhëse për periudhën	430	90	58	(85)	(3,998)	(3,505)
Përvetësimi i fitimit të mbartur	-	3	-	-	(3)	-
Gjendja më 31 Dhjetor 2017	25,477	5,326	(43)	(205)	1,706	32,261

Shifrat ekuivalente në Euro paraqiten vetëm për qëllime informimi dhe nuk janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të audituara (referoju shënimin 2 (e)).




Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare duhet të lexohet në lidhje me shënimet të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare që paraqiten nga faqa 8 deri në 54.

PROCREDIT BANK SH.A.

PASQYRA E MJETEVE MONETARE

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor



Shënime	Në LEK'000		Në EUR'000	
	2017	2016	2017	2016
Fluksi i parasë nga aktivitetet operative				
Fitimi i periudhës para tatimit	(581,834)	29,454	(4,338)	215
Regullime për të rakorduar fitimin përpara tatimit me fluksin e mjeteve monetare neto të siguruara nga aktivitetet operative				
Zhvierësimi dhe amortizimi i ndërtesave dhe pajisjeve dhe investimeve në ndërtesa	19,20	152,098	1,144	1,136
Zhvierësimi dhe amortizimi i aktiveve jo-materiale	21	31,690	238	249
Provizione për humbjet nga kredia	16	162,203	1,220	447
Të ardhura nga interesat	8	(1,340,420)	(10,082)	(12,067)
Shpenzime për interesat	8	200,764	1,510	1,864
Të ardhura nga shitja e aktiveve		(776)	(6)	(35)
Kthime nga provizione të tjera		75,450	568	36
		(1,300,825)	(9,746)	(8,155)
Ndryshime në aktive dhe detyrime operative:				
Rezerva e detyrueshme		322,382	2,425	228
Hua dhe paradhënie bankave dhe institucioneve të tjera financiare		543,774	4,090	6,454
Hua dhe paradhënie klientëve		(3,066,593)	(23,066)	17,958
Mjete të tjera		122,001	918	790
Prona të rimarra në pronësi		336,509	2,531	(2,888)
Detyrime ndaj bankave		2,735,035	20,572	(1,872)
Detyrime ndaj klientëve		(3,231,236)	(24,304)	(8,858)
Detyrime të tjera		117,247	882	(333)
		(3,421,706)	(25,698)	3,324
Interesa të arkëtuara		1,360,295	10,232	12,630
Interesa të paguara		(221,851)	(1,669)	(2,193)
Tatimi mbi fitimin i paguar		33,037	248	(44)
Fluksi i parasë neto nga aktivitetet operative		(2,250,225)	(16,887)	13,717
Fluksi i parasë neto nga aktivitetet investuese				
Blerja e letrave me vlerë të vendosjes		(1,424,507)	(10,715)	(20,203)
Të ardhura nga letrat me vlerë të vendosjes të maturuara		2,452,526	18,447	16,270
Të ardhura nga shitja e ndërtesave dhe pajisjeve		59,025	444	281
Blerja e aktiveve jo-materiale		(1,353)	(10)	(45)
Blerja e ndërtesave dhe pajisjeve		(67,816)	(510)	(1,296)
Fluksi i parasë neto përdorur në aktivitetet investuese		1,017,875	7,656	(4,993)
Fluksi i parasë nga aktivitetet financuese				
Rënia e borxhit të varur		(11,400)	(86)	(76)
Dividendi i paguar		-	-	(1,186)
Fonde të tjera të marra hua		1,859,500	13,986	
Fluksi neto i parasë (përdorur në) aktivitetet financuese		1,848,100	13,900	(1,262)
Diferenca nga kursi i këmbimit		-	462	358
Ndryshimi në mjete monetare dhe te ngjashme		615,750	5,131	7,820
Mjete monetare dhe të ngjashme në fillim të periudhës		3,985,199	29,471	21,650
Mjete monetare dhe të ngjashme në fund të periudhës	14	4,600,949	34,602	29,470

Shifrat ekuivalente në Euro paraqiten vetëm për qëllime informimi dhe nuk janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të audituara (referoju shënimit 2 (e)).

Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare duhet të lexohet në lidhje me shënimet të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare që paraqiten nga faqa 8 deri në 64



COSMOS TRANSLATION & EVENTS SH.P.K.

NIPT: LG1731002V

Rr. «Andon Zako Çajupi»

Prishtinë, Shk. 1, Ap. 5/6

Tirana, Albania

E-mail: info@cosmos-sh.com

www.cosmos-sh.com



1. Hyrje

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2017 për ProCredit Bank Sh.a. ("Banka").

ProCredit Bank Sh.a ("Banka"), e njohur fillimisht si FEFAD Bank Sh.a., u themelua me seli në Shqipëri në muajin shkurt të vitit 1999. Banka u licencua për të ushtruar aktivitetin e saj si një bankë në të gjitha fushat e aktivitetit bankar për individë në Shqipëri në përputhje me Ligjin nr. 9662 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Banka është një shoqëri aksionere e themeluar në përputhje me ligjin 9901, date 14 prill 2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Më 31 Dhjetor 2017 dhe 2016, aksionari i Bankës është shoqëria ProCredit Holding AG & Co. KGaA e cila zotëron 100% të aksioneve.

Aktiviteti kryesor. Aktiviteti kryesor i biznesit të Bankës përfshin ofrimin dhe realizimin e operacioneve bankare për bizneset dhe individët në Republikën e Shqipërisë. Banka ushtron aktivitetin e saj në bazë të licencës së plotë për ushtrimin e veprimtarisë bankare të lëshuar nga Banka Qendrore e Shqipërisë. Banka merr pjesë në skemën shtetërore të sigurimit të depozitave, e cila menaxhohet nga Agjencia Shqiptare e Sigurimit të Depozitave

Më 31 Dhjetor 2017, Banka ushtronte aktivitetin e saj nëpërmjet Drejtorisë Qendrore në Tiranë me 2 degë, 5 pika shërbimi, 2 qendra shërbimi dhe 10 zona vetë-shërbimi (Zona shërbimi 24 orë në ditë, 7 ditë në javë) të cilat ndodhen në Tiranë, Durrës, Fier, Elbasan, Korçë, Shkodër, Lezhë, Lushnje, Pogradec, Berat dhe Vlorë

Adresa e selisë dhe vendi i aktivitetit të biznesit. Adresa zyrtare e Bankës është Rruga "Dritan Hoxha", 92, P.O. Box 2395, Tiranë, Shqipëri.

Këshilli Drejtues

Anëtarët e Këshillit Drejtues janë si më poshtë:

- Borislav Kostadinov, Kryetari i Këshillit Drejtues
- Robert Scott Richards
- Wolfgang Bertelsmeier
- Mimoza Godanci
- Jordan Damcevski

Monedha funksionale dhe raportuese. Pasqyrat financiare janë të raportuara në Lek ("Lek"), e cila është në të njëjtën kohë edhe monedha funksionale e Bankës, monedha e mjedisit ekonomik kryesor ku Banka ushtron aktivitetin e saj. Me përjashtim të rasteve kur shprehet në mënyrë të veçantë, informacioni financiar i shprehur në Lek është rrumbullakosur në të njëjtën më të afërt

2. Përmbledhje e politikave kontabël

a) Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF") sipas konventës të kostos historike, e ndryshuar nga njohja fillestare e instrumenteve financiare në bazë të vlerës së drejtë, rivlerësimi i letrave me vlerë të vendosjes dhe investime në prona. Parimi i kontabilitetit që është zbatuar për përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare përcaktohet më poshtë. Këto politika janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme për të gjitha periudhat e prezantuara, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe.

Përmbledhje e çmuarjeve dhe gjykimeve kontabël. Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtimi të bëjë gjykime, çmuarjet dhe supozimet të cilat prekin zbatimin e politikave kontabël të Bankës dhe vlerat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të jenë të ndryshme nga këto çmuarje. Çmuarjet dhe supozimet në fjalë rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e çmuarjeve kontabël njihen në periudhën gjatë të cilës

Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare duhet të lexohet në lidhje me shënimet të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare që paraqiten nga faqa 8 deri në 64



rishikohen çmuarjet si dhe në periudha të tjera në të ardhmen. Informacioni për aspekte të rëndësishme të pasigurive të çmuarjeve dhe gjykimet e rëndësishme për zbatimin e politikave kontabël të cilat kanë efektin më të madh në vlerat e njohura në pasqyrat financiare janë të përfshira tek shënimi 5.

Përpyekje të vazhdueshme Drejtimi i Bankës përgatit pasqyrat financiare mbi baza të vazhdueshme. Në funksion të realizimit të saj, drejtimi në gjykimin e tij merr në konsideratë dhe vlerëson pozicionin financiar të Bankës, synimet aktuale, rentabilitetin e operacioneve dhe qasjen në burimet financiare, si dhe analizon ndikimin e situatës në tregun financiar në veprimtarinë dhe operacionet e Bankës. Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit të Bankës (RMK) në 31 dhjetor 2017 rezultoi 13.42%, ndërsa niveli minimal i raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit të parashikuar për bankat në Shqipëri është 12%. Gjatë vitit të mbyllur më 31 Dhjetor 2017, Banka ka realizuar humbje prej 536,204 mijë LEK kryesisht për shkak të një numri të transaksioneve të njëhershme me një ndikim të përgjithshëm prej 206,462 mijë Lekë dhe kostove dhe shpenzimeve të tjera jo të përsëritura gjatë vitit. Drejtimi i Bankës parashikon që Banka do të gjenerojë fitime duke filluar nga viti që përfundon më 31 dhjetor 2018 dhe do të përmbushë kërkesat minimale të raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit dhe do të vazhdojë në vijimësi për të ardhmen e parashikueshme.

2. Përmbledhje e çmuarjeve dhe gjykimeve kontabël (vazhdim)

b) Interesat

Të ardhurat dhe shpenzimet e interesit njihen në pasqyrën e të ardhurave me anë të metodës së normës efektive të interesit. Norma efektive e interesit është norma e cila bën aktualizimin e flukseve të pagesave dhe arkëtimeve të pritshme në të ardhmen gjatë jetëgjatësisë së pritshme të aktivit ose detyrimit financiar (ose sipas rastit mund të jetë një periudhë më e shkurtër) deri në shumën e mbartur të aktivit ose detyrimit financiar. Për përcaktimin e normës efektive të interesit, Banka vlerëson fluksin e parasë në të ardhmen, duke marrë në konsideratë kushtet kontraktore të instrumentit financiar, por jo humbjet e kredisë në të ardhmen

Llogaritja e normës efektive të interesit përfshin të gjitha komisionet e paguara ose të arkëtuara, shpenzimet për transaksionet që janë pjesë e normës efektive të interesit. Shpenzimet e transaksionit përfshijnë shpenzime shtesë që i atribuohen në mënyrë të drejtpërdrejtë blerjes ose emetimit të një aktivit ose detyrimi financiar.

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat të cilat paraqiten në pasqyrën e fitim humbjeve dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse (ATP/OCI) përfshijnë:

- interesat për aktivet financiare dhe detyrimet financiare të cilat maten me koston e amortizuar llogariten në bazë të normës efektive të interesit; dhe
- interesat për investime në letra me vlerë të vendosjes llogariten në bazë të normës efektive të interesit


c) Të ardhurat dhe shpenzimet nga komisionet

Komisionet që janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit përfshijnë gjenerimin e komisioneve të arkëtuara ose të paguara nga subjekti në lidhje me krijimin ose blerjen e një aktivit financiar ose lëshimin e një detyrimi financiar, për shembull komisionet për vlerësimin e aftësisë paguese, vlerësimin dhe regjistrimin e garancive ose kolateralit, duke negociuar kushtet e instrumentit dhe për përpunimin e dokumenteve të transaksionit.

Komisionet e angazhimit të marra nga Banka për të dhënë kredi me normat e interesit të tregut janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit nëse ka gjasa dhe mundësi që Banka do të hyjë në një angazhim specifik kreditimi dhe nuk parashikon të shesë kredinë që rezulton menjëherë pas dhënies së saj. Të gjitha tarifat, komisionet dhe të ardhurat dhe shpenzimet e tjera në përgjithësi regjistrohen në momentin e realizimit të tyre duke iu referuar përfundimit të transaksionit specifik të vlerësuar në bazë të shërbimit aktual të ofruar si pjesë e shërbimeve të përgjithshme që do të ofrohen. Të ardhurat dhe shpenzimet e tjera nga komisionet përbëhen nga komisione nga (për): karta krediti, komisione për mirëmbajtje dhe shërbim llogarie, pagesa brenda vendit, pagesa ndërkombëtare, pagesa me Bankën Qendrore, shërbimin SMS banking, letër kredi si dhe komisione të tjera. Të ardhurat e tjera nga komisionet, njihen në momentin e kryerjes së shërbimeve. Shpenzimet të tjera për komisionet lidhen kryesisht me komisionet për transaksione dhe shërbime, të cilat kalojnë në shpenzime në momentin e marrjes së shërbimit të ofruar.



Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare duhet të lexohet në lidhje me shënimet të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare që paraqiten nga faqa 8 deri në 64



d) Qiraja operative

Shpenzimet për qiranë operative njihen në pasqyrën e të ardhurave në mënyrë lineare përgjatë kohëzgjatjes së qirasë. Incentivat e qirasë njihen si pjesë integrale të totalit të shpenzimeve për qiratë gjatë kohëzgjatjes së qirasë.

e) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet e këmbimeve valutore janë kthyer në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të vlefshëm në datën e transaksioneve.

Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit janë këmbyer në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të vlefshëm në datën e këmbimit.

Fitimi ose humbja nga këmbimet valutore të zërave monetar është diferenca midis kostos së amortizuar në monedhën funksionale në fillim të periudhës, rregulluar për interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj të këmbyer me kursin e këmbimit të ditës në fund të periudhës.

Zërat jo-monetar të cilat maten me koston historike në monedhë të huaj konvertohen me kursin historik të këmbimit në datën e transaksionit. Diferencat e konvertimit të cilat rezultojnë nga rikonvertimet njihen përgjithësisht në pasqyrën e të ardhurave

Shifrat ekuivalente në Euro

Krahas paraqitjes së pasqyrave financiare në LEK, informacioni plotësues në Euro është përgatitur për qëllime informimi të përdoruesve të pasqyrave financiare, duke konvertuar shifrat nga LEK'000 në EUR'000.

Pasqyra e pozicionit financiar dhe pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017 janë konvertuar me kursin e këmbimit zyrtar të Bankës së Shqipërisë në datën 31 Dhjetor 2017 prej 132.95 LEK për 1 Euro (2016: 135.23). Pasqyra e ndryshimeve në kapital nuk është konvertuar me normën historike të kursit të këmbimit duke paraqitur këtë prezantim në mënyrë të vazhdueshme. Kapitali aksioner me normën historike të kursit të këmbimit është 25,699 mijë euro (shih shënimin 26) dhe nuk ndryshon shumë nga 25,477 mijë euro, siç paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar. Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe e të ardhurave përmbledhëse dhe pasqyra e fluksit të mjeteve monetare janë konvertuar me kursin e këmbimit mesatar për vitin prej 134.13 LEK për 1 Euro (2016: 137.37 LEK për 1 Euro)

2. Përmbledhje e çmuarjeve dhe gjykimeve kontabël (vazhdim)

f) Tatimi mbi fitimin

Shpenzimet për tatimet përfshijnë tatimin afatshkurtër dhe tatimin e shtyrë. Tatimi afatshkurtër dhe tatimi i shtyrë njihen në pasqyrën e të ardhurave me përjashtim kur i referohet zërave të cilët njihen direkt në kapital ose tek të ardhurat e tjera përmbledhëse.

(i) Tatimi afatshkurtër


Tatimi afatshkurtër është tatimi që pritet të paguhet ose të arkëtohet për të ardhurat e tatueshme ose shpenzimet për periudhën, duke përdorur normat e taksave në fuqi ose të cilat hyjnë në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo rregullim të tatimit që duhet të paguhet në lidhje me vitet e mëparshme.

(ii) Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë përllogaritet mbi diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës së mbartur të të drejtave dhe detyrimeve për qëllime raportimi dhe vlerës së përdorur për qëllime tatimi. Tatimi i shtyrë nuk përllogaritet mbi diferencat e përkohshme të njohjes fillestare të aktiveve ose detyrimeve në një transaksion i cili nuk është një kombinim biznesi dhe nuk ka ndikim as mbi kontabilizimin si dhe as në të ardhurat e tatueshme apo shpenzimet.

Të drejtat tatimore të shtyra njihen për humbjet e papërdorura tatimore, kreditimet tatimore të papërdorura dhe diferencat tatimore të zbritshme deri në atë nivel ku është e mundur që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të materializohet. Të drejtat tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen deri në atë nivel që nuk ka më mundësi që të realizohet fitimi nga tatimet.

Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare duhet të lexohet në lidhje me shënimet të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare që paraqiten nga faqa 8 deri në 64



Tatimi i shtyrë matet me normat e tatimeve të cilat janë parashikuar të zbatohen mbi diferencat e përkohshme në momentin e kthimit të tyre, duke përdorur normat e tatimeve në fuqi ose që hyjnë në fuqi në datën e raportimit.

Të drejtat dhe detyrimet tatimore të shtyra kompensohen me njëra-tjetrën, nëse një e drejtë e detyrueshme ligjore ekziston për të kompensuar të drejta dhe detyrime tatimore afatshkurtër dhe lidhen me taksat të vendosura nga i njëjti autoritet tatimor për subjekte të njëjta tatimore ose subjekte të ndryshme tatimore, por ata kanë si qëllim të likuidojnë detyrimet dhe të drejtat tatimore afatshkurtra neto ose të drejtat dhe detyrimet e tyre tatimore do të realizohen njëkohësisht.

(iii) Ekspozimi tatimor

Pozicionet e pasigurta tatimore të Bankës rivlerësohen nga drejtimi i bankës në fund të çdo periudhe raportuese. Detyrimet regjistrohen për pozicionet e tatimit mbi të ardhurat të cilat përcaktohen nga drejtimi i bankës, pasi ka më shumë gjasa që të mos rezultojë në vendosjen e taksave shtesë nëse pozicionet do të kundërshtoheshin nga autoritetet tatimore. Vlerësimi bazohet në interpretimin e ligjeve tatimore që janë miratuar dhe në fuqi ose që do të hyjnë në fuqi në fund të periudhës së raportimit, dhe të çdo vendimi gjykate ose të autoriteteve të tjera për këto çështje. Detyrimet për penaltitetet dhe gjokat, interesat dhe tatimet tjera të ndryshme nga të ardhurat njihen në bazë të vlerësimit dhe çmuarjes më të mirë nga ana e drejtimit të shpenzimeve të nevojshme për të shlyer detyrimet në fund të periudhës së raportimit.

g) Instrumentet financiare

(i) Njohja

Banka fillimisht njihet huat dhe paradhëniet, depozitat dhe huamarrjet në datën kur ato janë krijuar. Të gjitha instrumentet e tjera financiare (duke përfshirë blerjet dhe shitjet e rregullta të aktiveve financiare) njihen në datën e tregtimit në të cilën Banka bëhet palë për respektimin e dispozitave kontraktuale të instrumentit.

Aktivi ose detyrimi financiar matet fillimisht me vlerën e drejtë plus kostot e transaksionit, për një instrument që nuk matet me vlerë të drejtë nëpërmjet pasqyrës së të ardhurave, kostot e transaksionit të cilat i atribuohen direkt blerjes ose emetimit të tij.

(ii) Klasifikimi

Aktivitet financiare

Banka klasifikon aktivitetet e saj financiare në një nga kategoritë e mëposhtme:

- Hua dhe të arkëtueshme;
- Letra me vlerë të vendosjes

Shikoni shënimet (h), (i) dhe (j).

Drejtimi i Bankës përcakton klasifikimin e investimeve të saj me njohjen fillestare. Banka nuk ka klasifikuar ndonjë aktiv financiar me vlerë të drejtë përmes pasqyrës së të ardhurave të shpenzimeve gjatë periudhës së raportimit.

Detyrimet financiare

Banka i klasifikon detyrimet e saj financiare, ndryshe nga garancitë financiare dhe angazhimet e huas, si të matura me koston e amortizimit. Shikoni shënimet (o) dhe (p).

(iii) Mos-njohja


2. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

Aktivitet financiare

Banka nuk e njihet më një aktiv financiar nëse të drejtat kontraktuale për fluksin e parave nga aktivi financiar janë shuar, ose nëse transferohen të drejtat për të marrë përfitimin kontraktual nga aktivi financiar në një transaksion nëpërmjet të cilit transferohen të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë mbi aktivin financiar ose në të cilin Banka nuk transferon dhe nuk mban në mënyrë thelbësore të gjitha rreziqet dhe shpërblimet e pronësisë si dhe nuk gëzon kontrollin ndaj aktivitetit financiar.

Për mos njohjen e një aktivi financiar, diferenca midis vlerës së mbartur të aktivitetit (ose vlera e mbartur që i është caktuar pjesës së aktivitetit që nuk njihet) dhe shumës së (i) pagesës së arkëtuar (duke përfshirë aktivin e ri që është marrë duke i zbritur

Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare duhet të lexohet në lidhje me shënimet të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare që paraqiten nga faqa 8 deri në 64



NIPET: L01731002V

Rr. 'Andon Zako Çajupi'
P.20/4, Shk. I, Ap.5/6
Tirana - Albania
E-mail: info@cosmos-al.com
www.cosmos-al.com

PROCREDIT BANK SH.A.
SHËNIME SHOQËRUESE MBI PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017

(Të gjitha shumat shprehen në LEK'000, përveçse kur është shprehur ndryshe)



detyrimet e reja të supozuara) dhe (ii) çdo fitim ose humbje kumulative që është njohur në pasqyrën e të ardhurave të tjera përmbledhëse, njihet në pasqyrën e të ardhurave. Çdo interes në aktivet financiare të transferuara, të cilat kualifikohen për mos-njohje, që krijohet ose mbahet nga Banka njihet si një aktiv ose detyrim më vete.

Banka nuk njeh një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale janë shfuqizuar, anuluar ose kur u skadon afati.

(iv) Kompensimi i instrumenteve financiare

Aktivitet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe vlera neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar kur dhe vetëm kur Banka gëzon të drejtën ligjore për të bërë kompensimin e shumave dhe vlerave, dhe ka si qëllim likuidimin mbi bazën neto ose likuidimin e aktivitet dhe shlyerjen e detyrimit njëkohësisht. Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten neto vetëm nëse lejohen nga standardet e kontabilitetit – Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar

(v) Matja me kosto të amortizuar

Kostoja e amortizuar e aktivitet ose detyrimit financiar përbën shumën me të cilën aktivitet dhe detyrimi financiar matet në fazën e njohjes fillestare, minus kthimin e principalit, plus vlerën e interesit të akumuluar dhe për aktive financiare minus ndonjë fshirje për shpenzimet e kryera për provigjionimin. Interesi i akumuluar përfshin amortizimin e kostove të transaksionit në njohjen fillestare dhe të ndonjë primi ose zbritje të shumës së maturuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Të ardhurat e akumuluar nga interesi dhe shpenzimet e akumuluar për interesat, duke përfshirë si kuponin e akumuluar dhe zbritjen e amortizuar ose primin (përfshirë komisionet e shtyra në momentin e realizimit, nëse ka) nuk paraqiten të ndara më vete dhe përfshihen në vlerat kontabël të zërave përkatës në pasqyrën e pozicionit financiar.

Metoda e interesit efektiv është një metodë e ndarjes së të ardhurave nga interesi ose shpenzimeve për interesat gjatë periudhës përkatëse, në mënyrë që të arrihet një normë konstante e interesit periodik (norma efektive e interesit) në vlerën kontabël. Norma efektive e interesit është norma që zbrit me saktësi pagesat e ardhshme në mjete monetare cash ose faturat (duke përfshirë humbjet e ardhshme të kredisë) përgjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar ose një periudhe më të shkurtër, nëse është e përshtatshme, në vlerën kontabël neto të instrumentit financiar.

(vi) Matja me vlerën e drejtë


- Vlera e drejtë' është çmimi i cili do të përcaktohet për të shitur një aktiv ose do të paguhet për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt midis pjesëmarrësve në treg në datën e matjes. Evidenca më e mirë e vlerës së drejtë është çmimi në një treg aktiv. Një treg konsiderohet si treg aktiv nëse transaksionet për aktivitet dhe detyrimet ndodhin me një frekuencë dhe në volume të mjaftueshme për të paraqitur informacion dhe të dhëna për çmimin në mënyrë të vazhdueshme.

Vlera e drejtë e instrumenteve financiare të tregtuara në një treg aktiv matet si produkt i çmimit të kuotuar për aktivin ose pasivin individual dhe sasinë e mbajtur nga njësisia ekonomike. Derivatet financiare ose aktivitet dhe detyrimet e tjera financiare që nuk tregtohen në një treg aktiv, maten me vlerën e drejtë të një grupi të aktiveve dhe detyrimeve financiare në bazë të çmimit që do të merret për të shitur një pozicion neto afat gjatë (p.sh. një aktiv) për një ekspozim të veçantë të rrezikut ose që do të paguhej për të transferuar një pozicion neto afat shkurtër (p.sh. një detyrim) për një ekspozim të veçantë ndaj rrezikut në një transaksion të rregullt ndërmjet pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes. Kjo është e zbatueshme për aktivitet e mbajtura me vlerën e drejtë në mënyrë të vazhdueshme nëse Banka: (a) menaxhon grupin e aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare në bazë të ekspozimit neto të subjektit ndaj një rreziku të veçantë (ose rreziqesh) të tregut ose ndaj rrezikut të kredisë të një kundërpale të veçantë në përputhje me strategjinë e dokumentuar të administrimit të rrezikut ose të strategjisë së investimit; (b) jep informacion mbi këtë bazë në lidhje me grupin e aktiveve dhe detyrimeve ndaj drejtuesve kryesor të subjektit; dhe (c) rreziqet e tregut, duke përfshirë kohëzgjatjen e ekspozimit të subjektit ndaj një rreziku (ose rreziqeve) të veçantë të tregut që rrjedhin nga aktivitet financiare dhe detyrimet financiare, janë kryesisht të njëjta.

Teknikat e vlerësimit si modelet e zbritjes së fluksit të parasë ose modelet e bazuara në transaksionet e fundit sipas tregut, ose vlerësimi i të dhënave financiare të investitorëve, përdoren për të matur vlerën e drejtë të instrumenteve të caktuar financiarë për të cilat nuk ekzistojnë informacione mbi çmimet. Matjet e vlerës së drejtë analizohen sipas nivelit në hierarkinë e vlerës së drejtë si më poshtë vijon: (i) niveli i parë janë matjet me çmime të kuotuar (të parregulluara) në tregjet aktive për aktivitet ose detyrimet identike, (ii) matjet e nivelit të dytë janë teknikat e vlerësimit me të gjitha të dhënat material të vëzhgueshme për aktivitet ose detyrimet, qoftë në mënyrë direkte (pra çmimet) ose indirekte (që rezultojnë nga çmimet) dhe (iii) matjet e nivelit të tretë janë vlerësime që nuk bazohen vetëm në të dhënat e vëzhgueshme të tregut (domethënë matja kërkon të dhëna të konsiderueshme jo të vëzhgueshme).

Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare duhet të lexohet në lidhje me shënimet të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare që paraqiten nga faqa 8 deri në 64





2. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(vii) Identifikimi dhe matja e zhvlerësimeve

Zhvlerësimi i huave dhe paradhënieve

Në çdo datë raportimi, Banka vlerëson nëse ekzistojnë fakte objektive që një aktiv financiar ose një grup i aktiveve financiare janë të zhvlerësuara.

Nëse ekzistojnë fakte objektive që vërtetojnë se ka ndodhur zhvlerësimi i një ekspozimi kredie ose i një portofoli të ekspozimeve të kredisë i cili ka një impakt në flukset e ardhshme të parasë të aktivitetit financiar (aktiveve), humbjet e përkatëse njihen menjëherë.

Zhvlerësimi i huave dhe paradhënieve

Në çdo datë raportimi, Banka vlerëson nëse ekzistojnë fakte objektive që një aktiv financiar ose një grup i aktiveve financiare janë të zhvlerësuara. Një aktiv financiar ose një grup i aktiveve financiare zhvlerësohen vetëm nëse ka fakte objektive të zhvlerësimit si rezultat i një ose më shumë ngjarjeve që kanë ndodhur pas njohjes fillestare të aktivitetit (një 'ngjarje humbjeje') dhe ose nëse ngjarja e humbjes (ose ngjarjet) ka një ndikim në flukset e ardhshme të parasë të parashikuara të aktivitetit financiar ose grupit të aktiveve financiare që mund të vlerësohen në mënyrë të besueshme. Kriteret që Banka përdor për të përcaktuar se ekzistojnë fakte objektive për një humbje nga zhvlerësimi përfshijnë si më poshtë vijon:

- moskryerja e pagesave të principalit dhe interesave sipas kontratës;
- probleme me flukset monetare cash me të cilat përballet kredimarrësi (për shembull raportimi i kapitalit, përqindja e të ardhurave neto nga shitjet;
- shkelja e kushteve dhe afateve të kredisë;
- fillimi i procedurave të falimentimit;
- përkeqësimi i pozicionit konkurrues të kredimarrësit; dhe
- Përkeqësimi i vlerës së kolateralit.

Periodha e parashikuar midis humbjeve që ndodhin dhe identifikimit të tyre përcaktohet nga drejtimi lokal i bankës për çdo portofol të identifikuar. Në përgjithësi, periudhat që aplikohen variojnë nga tre muaj deri në 12 muaj; në raste të jashtëzakonshme, garantojnë periudha më të gjata.

Banka vlerëson në fillim nëse ekzistojnë faktet objektive të zhvlerësimit veçmas në mënyrë individuale për aktivet financiare të cilat janë të rëndësishme më vete, dhe veçmas ose në mënyrë kolektive për aktivet financiare të cilat nuk janë të rëndësishme më vete. Nëse banka vlerëson se nuk ekziston asnjë fakt objektiv për zhvlerësimin e një aktivi financiar të vlerësuar në mënyrë individuale, qoftë i rëndësishëm ose jo, ajo përfshin aktivin në një grup aktiveve financiare me karakteristika të ngjashme të rrezikut të kredisë dhe i vlerëson ato në mënyrë kolektive për zhvlerësim. Aktivet të cilat vlerësohen në mënyrë individuale për zhvlerësim dhe për të cilat vazhdon të njihet një humbje nga zhvlerësimi nuk përfshihen në vlerësimin kolektiv për zhvlerësim.


Shuma e humbjes matet si diferenca midis vlerës kontabël neto të aktivitetit dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të ardhshme të vlerësuara (duke përjashtuar humbjet e ardhshme nga kredia, të cilat nuk kanë ndodhur) të skontuara me normën fillestare të interesit efektiv të aktivitetit financiar. Vlera kontabël e aktivitetit është zvogëluar nëpërmjet përdorimit të llogarisë së provigjionimit dhe shuma e humbjes njihet në pasqyrën e të ardhurave për periudhën.

Llogaritja e vlerës aktuale të fluksit të ardhshëm të parasë të një aktivi financiar i cili është vendosur si garanci pasqyron fluksin e parasë që mund të rezultojë nga mbyllja minus kostot sigurimin dhe shitjen e kolateralit, në rast se mbyllja është e mundur ose jo.

Për qëllime të vlerësimit të zhvlerësimit kolektiv, aktivet financiare grupohen në bazë të karakteristikave të ngjashme të rrishtit të kredisë (p.sh. sipas numrit të ditëve të vonesave, sipas procesit të klasifikimit të bankës i cili vlerëson llojin e aktivitetit, industrinë, vendndodhjen gjeografike, llojin e kolateralit dhe faktorë të tjerë të rëndësishëm). Këto karakteristika janë relevante për vlerësimin e flukseve monetare të ardhshme për grupet e këtyre aktiveve duke demonstruar treguesin e aftësisë së debitorit për të paguar të gjitha shumat e duhura sipas kushteve kontraktuale të aktiveve që janë subjekt vlerësimi.

(vii) Identifikimi dhe matja e zhvlerësimeve

Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare duhet të lexohet në lidhje me shënimet të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare që paraqiten nga faqa 8 deri në 64



COSMOS TRANSLATIONS
& EVENTS SH.P.K.

NIPT: L01731002V


Rr. «Andon Zako Çajupi»
P.20/4, Shk. 1, Ap.5/6

Tirana - Albania
E-mail: info@cosmos-
www.cosmos-
sh.p.k.

PROCREDIT BANK SH.A.
SHËNIME SHOQËRUESE MBI PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017

(Të gjitha shumat shprehën në LEK'000, përveçse kur është shprehur ndryshe)



Të gjitha ekspozimet e kredisë në vlerën prej EURO 30,000 ose më shumë vlerësohen individualisht, ndërsa ekspozimet e kredisë poshtë këtij pragu konsiderohen të parëndësishme dhe vlerësohen në mënyrë kolektive duke paraqitur treguesit e ngjarjeve të humbjes. Për ekspozimet e parëndësishme të kredive të zhvlerësuara, nivelet e provigjionimit llogariten nga Banka në bazë të përvojës së saj historike në mjedisin ekonomik që ushtron aktivitetin.

Flukset e ardhshme të parasë në një grup të aktiveve financiare të cilat vlerësohen në mënyrë kolektive për zhvlerësim përlogariten në bazë të flukseve të parasë kontraktore të aktiveve në grup dhe eksperiencës së humbjes historike për aktive me karakteristika të ngjashme të riskut të kredisë më ato të Bankës. Eksperienca e humbjes historike rregullohet në bazë të të dhënave aktuale të evidentueshme dhe të vëzhgueshme për të pasqyruar efektet e kushteve aktuale që nuk cenuan periudhën në të cilën bazohet eksperiencia e humbjes historike dhe për të hequr efektet e kushteve në periudhën historike që nuk ekzistojnë aktualisht

2. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

Çmuarjet e ndryshimeve në flukset e ardhshme të parasë për grupe të aktiveve financiare duhet të pasqyrojnë dhe duhet të jenë në përputhje me ndryshimet në të dhënat përkatëse të vëzhgueshme nga periudha në periudhë (për shembull, ndryshimet në normat e papunësisë, çmimet e pronave, statusi i pagesës ose faktorë të tjerë që tregojnë ndryshime në probabilitetin e humbjeve në Bankë dhe madhësinë e tyre). Metodologjia dhe supozimet që përdoren për vlerësimin e flukseve të ardhshme të parasë rishikohen rregullisht nga Banka për të zvogëluar çdo diferencë midis vlerësimit dhe përlogaritjeve të humbjes dhe eksperiencës së humbjes aktuale.

Nëse një hua nuk mund të arkëtohet, ajo fshihet kundrejt provizionit përkatës për zhvlerësimin e huas. Këto hua fshihen pas përfundimit të të gjitha procedurave të nevojshme dhe përcaktimit të shumës së humbjes.

Nëse, në një periudhë të mëvonshme, shumata e humbjes së zhvlerësuar zvogëlohet ose dhe zvogëlimi lidhet objektivisht me një ngjarje që ka ndodhur pas njohjes së zhvlerësimit (si përmirësimi i klasifikimit të kredisë të kredimarrësit) humbja nga zhvlerësimi që është njohur më parë, kthehet duke rregulluar llogarinë e provizionit. Shumata e kthimit njihet në pasqyrën e të ardhurave, zhvlerësimi për humbjet nga kreditë.

Zhvlerësimi i letrave me vlerë të vendosjes

Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave për vitin kur kanë ndodhur si rezultat i një ose më shumë ngjarjeve ("ngjarje të humbjeve") që kanë ndodhur pas njohjes fillestare të investimit në letrave me vlerë të vendosjes. Rënia e ndjeshme dhe madhe në vlerën e drejtë të letrës me vlerë nën koston e saj merret në konsideratë për të përcaktuar nëse aktiviteti janë zhvlerësuar. Humbja kumulative e zhvlerësimit - e cila vlerësohet dhe matet si diferenca midis kostos së blerjes dhe vlerës së drejtë aktuale, duke zbritur humbjet nga zhvlerësimi të aktiveve financiare të cilat janë njohur më parë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, hiqet nga zëri i të ardhurave të tjera përmbledhëse dhe njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Humbjet nga zhvlerësimi që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve për instrumentet e kapitalit nuk kthehen përmes pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve. Nëse në një periudhë të mëvonshme, vlera e drejtë e instrumentit të borxhit që klasifikohet në kategoritë e letrës me vlerë të vendosjes rritet, dhe rritja lidhet objektivisht me një ngjarje që ndodh pas datës së zhvlerësimit, humbja është njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, humbja nga zhvlerësimi kthehet përmes pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve për periudhën.

Ekspozimet e ristrukturuara të kredisë


Ekspozimet e ristrukturuara të kredive që janë me vonesë ose të zhvlerësuara dhe që konsiderohen të jenë individualisht të rëndësishme vlerësohen në baza individuale (shih më lart). Kreditë e ristrukturuara të cilat janë individualisht të parëndësishme vlerësohen kolektivisht për zhvlerësim.

h) Mjete monetare dhe të ngjashme

Mjete monetare dhe të ngjashme përfshijnë mjetet në arkë, llogaritë me bankat, gjendjet e pakufizuara me bankat qendrore dhe depozitat afatshkurtra shume likuide me maturitet më pak se tre muaj ose më pak se data e blerjes, të cilat janë subjekti i ndryshimeve jo të rëndësishme të vlerës së tyre të drejtë dhe përdoren nga Banka për përmbushjen e angazhimeve të saj afatshkurtra.

Mjete monetare dhe të ngjashme mbahen në bilanc me koston e amortizuar.


Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare duhet të lexohet në lidhje me shënimet të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare që paraqiten nga faqa 8 deri në 64



COSMOS TRANSLATIONS
EVENTS SH.P.K.

NIPT: L01731002V

Rr. Andon Zako Çajupi
P.20/4, Sh.1, Ap.1/6
Tirana - Albania
E-mail: info@cosmos-
www.cosmos-
12



i) Hua dhe paradhënie

Huat dhe paradhëniet për bankat dhe klientët janë aktive financiare jo derivative me pagesa fikse ose të përcaktueshme të cilat nuk janë të kuotuar në një treg aktiv dhe Banka nuk ka për qëllim shitjen e tyre të menjëhershme ose në një kohë të afërt.

Huat dhe paradhëniet maten në fillim me vlerën e drejtë dhe më pas me koston e amortizimit plus kostot e tjera të transaksioneve direkte, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Kur Banka ble një aktiv financiar dhe në të njëjtën kohë nënshkruan një marrëveshje për rishitjen e aktivit (ose një aktivi tjetër të ngjashëm) me një çmim të caktuar fiks në datë të caktuar (marrëveshjet e riblerjes së anasjelltë), marrëveshja kontabilizohet si një hua ose paradhënie, dhe aktivi në fjalë nuk njihet në pasqyrat financiare të bankës.

j) Aktive financiare letra me vlerë të vendosjes

Investimet në letra me vlerë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus kostot e tjera të transaksioneve direkte.

Investimet në letrat me vlerë të vendosjes janë instrumente jo derivative të cilat nuk përbëjnë një kategori tjetër të aktiveve financiare. Letrat me vlerë të vendosjes përfshijnë letrat me vlerë të kapitalit dhe letra me vlerë të borxhit. Letrat me vlerë të borxhit të pakuotuar, vlera e drejtë e të cilave nuk mund të matet në mënyrë të besueshme, mbahen me kosto. Të gjitha letrat me vlerë të vendosjes maten me vlerën e drejtë pas njohjes fillestare.

2. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

Te ardhurat nga interesi njihen në pasqyrën e të ardhurave nëpërmjet metodës së interesit efektiv. Të ardhurat nga dividendët njihen në pasqyrën e të ardhurave kur Banka gëzon të drejtën mbi dividendin. Fitimet ose humbjet nga këmbimet valutore të investimeve në letra me vlerë të vendosjes njihen në pasqyrën e të ardhurave. Humbjet nga zhvlerësimi njihen tek pasqyra e të ardhurave. (shih shënimet në pikën (f)(vii)).

Ndryshime të tjera të vlerës së drejtë, përveç humbjeve nga zhvlerësimi (shih shënimet në pikën (f)(vii)) njihen tek pasqyra e të ardhurave të tjera përmbledhëse dhe paraqitet në rezervën e vlerës së drejtë të kapitalit. Nëse investimi shitet, gjendja në kapital riklasifikohet në pasqyrën e të ardhurave.

k) Investimet në prona

Investimet në prona mbahen nga Banka për të fituar të ardhura nga qiraja ose për vlerësimin e kapitalit, ose për të dyja qëllimet. Investimet në prona përfshijnë aktivet për përdorime në të ardhmen për qëllime investimi.

Investimet në prona paraqiten me koston e tyre historike neto pasi iu është zbritur zhvlerësimi i akumuluar dhe ndonjë humbje nga zhvlerësimi. Nëse ekziston ndonjë tregues që investimi në prona mund të zhvlerësohet, Banka vlerëson shumën e rikuperueshme si vlera më e lartë në përdorim dhe vlerën e drejtë minus kostot e shitjes. Vlera kontabël neto e një investimi në pronë shënohet deri në shumën e rikuperueshme nëpërmjet një pagese në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve për periudhën. Humbja nga zhvlerësimi e njohur në vitet e mëparshme kthehet nëse ka pasur një ndryshim të mëvonshëm në vlerësimet dhe çmuarjet e përdorura për të përcaktuar shumën e rikuperueshme të aktivit

Shpenzimet e mëtejshme janë përfshirë në vlerën e mbartur të aktivit, ose njihen si një aktiv më vete, sipas rasis, në rast se ekzistojnë mundësi të rrisin të mirat e ardhshme ekonomike të këtij mjeti specifik në Bankë dhe shpenzimet e aktivit mund të maten në mënyrë të besueshme. Të gjitha riparimet e tjera dhe mirëmbajtja klasifikohen tek shpenzimet operative gjatë periudhës financiare gjatë cilës janë kryer këto shpenzime. Nëse investimi në pronë zotërohet nga pronari, ajo klasifikohet tek ndërtesat dhe pajisjet.

Të ardhurat e fituara nga qiraja regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin në kategorinë e të ardhurave të tjera operative. Fitimet dhe humbjet që rrjedhin nga ndryshimet në vlerën e drejtë të investimit në pronë regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin dhe paraqiten më vete.

l) Ndërtesat dhe pajisjet

Ndërtesat dhe pajisjet dhe investimet në prona paraqiten me koston e tyre historike neto pasi iu është zbritur zhvlerësimi i akumuluar dhe ndonjë humbje nga zhvlerësimi. Kostot historike përfshijnë të gjitha shpenzimet të cilat mund t'i atribuohen në mënyrë të drejtpërdrejtë blerjes së aktivit dhe mjetit.

Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare duhet të lexohet në lidhje me shënimet të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare që paraqiten nga faqa 8 deri në 64



COSMOS TRANSLATIONS
P. 2014, Shk. 1, Ag. 518,
Tirana - Albania
E-mail: info@cosmos.com
www.cosmos.com

PROCREDIT BANK SH.A.
SHËNIME SHOQËRUESE MBI PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin e mbylltur më 31 Dhjetor 2017

(Të gjitha shumat shprehen në LEK'000, përveçse kur është shprehur ndryshe)



Shpenzimet e mëtejshme janë përfshirë në vlerën e mbartur të aktivit, ose njihen si një aktiv më vete, sipas rasti, në rast se ekzistojnë mundësi të rrisin të mirat e ardhshme ekonomike të këtij mjeti specifik në Bankë dhe shpenzimet e aktivit mund të maten në mënyrë të besueshme. Të gjitha riparimet e tjera dhe mirëmbajtja klasifikohen tek shpenzimet operative gjatë periudhës financiare gjatë cilës janë kryer këto shpenzime.

Vlera kontabël e ndërtesave dhe pajisjeve dhe investimeve në prona rishikohen për zhvlerësim nëse ngjarjet ose ndryshimet e rrethanave evidentojnë se vlera kontabël nuk mund të rikuperohet. Nëse ekzistojnë këto tregues dhe nëse vlera e mbartur tejkalon shumën e përlogaritur që mund të rikuperohet, aktive ose njësitë gjeneruese të mjeteve monetare fshihen nga shuma e tyre e rikuperueshme. Shuma e rikuperueshme e ndërtesave dhe pajisjeve është shuma më e madhe e vlerës së drejtë duke i zbritur shpenzimet për shitjen e tyre dhe vlerën në përdorim..

Shuma e rikuperueshme e ndërtesave dhe pajisjeve është shuma më e madhe e vlerës së drejtë duke i zbritur shpenzimet për shitjen e tyre dhe vlerën në përdorim. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset monetare të ardhshme të parashikuara skontoohen në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën kohë të parasë dhe rreziqet specifike për aktivet

Për një aktiv që nuk gjeneron flukse monetare kryesisht të pavarura, shuma e rikuperueshme përcaktohet për njësinë gjeneruese të mjeteve monetare të cilës i takon aktivi. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Trojet dhe aktivet në ndërlim nuk zhvlerësohen. Zhvlerësimi i aktiveve realizohet duke përdorur metodën lineare sipas normave të përcaktuara për koston dhe shpenzimet për pronën dhe pajisjet gjatë kohëzgjatjes së përdorimit të tyre. Normat vjetore të zhvlerësimit përcaktohen në bazë të jetëgjatësisë së parashikuar të aktiveve të caktuara sipas tabelës që paraqitet më poshtë:

Përshkrimi	Jetëgjatësia
Kompjuter dhe pajisje elektronike	5 vjet
Automjete	5 vjet
Mobilje dhe pajisje	10 vjet
Ndërtesa	40 vjet

2. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

Ndërtesat dhe pajisjet me jetëgjatësi më shumë se një vit që klasifikohen nën pragun e materialitetit prej 5'000 lekë (2016: 5'000 lekë) dhe gjithashtu nuk janë materiale në total, paraqiten në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Përmirësimet e qirasë janë zhvlerësuar gjatë periudhës më të shkurtër të jetëgjatësisë dhe afatit të qirasë

Vlerat e mbetura të aktiveve dhe jetëgjatësia e përdorimit rishikohen dhe rregullohen, sipas rasti, në datën e raportimit. Fitimet dhe shpenzimet për shitjet përcaktohen duke krahasuar të ardhurat me vlerën e mbartur. Këto përfshihen në zërin e të ardhurave të tjera ose në zërin e shpenzimeve të tjera operative (sipas rasti) të pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve.

m) Aktive afat-gjata jomateriale

Aktive afat-gjata jomateriale njihen në rast se ekzistojnë mundësi të rrisin të mirat e ardhshme ekonomike të këtij mjeti specifik në Bankë dhe shpenzimet e aktivit mund të maten në mënyrë të besueshme. Aktive afat-gjata jomateriale maten dhe vlerësohen fillimisht me kosto. Vlera kontabël e aktiveve afat-gjata jomateriale rishikohen për zhvlerësim nëse ngjarjet ose ndryshimet e rrethanave evidentojnë se vlera e mbartur nuk mund të rikuperohet. Aktive afat-gjata jomateriale përfshijnë programet kompjuterike të cilat amortizohen duke përdorur metodën lineare të amortizimit për të gjithë jetëgjatësinë e dobishme prej dhjetë vjet.

Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare duhet të lexohet në lidhje me shënimet të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare që paraqiten nga faqa 8 deri në 64



COSMOS TRANSLATIONS
& EVENTS B.R.K.

NIP: 161731602V


14

Pr. "Andrea Zefo Çorogji"
P.2004, Str. 1, Et. 5
Tirana - Albania
E-mail: info@cosmos-brk.com
www.cosmos-brk.com

PROCREDIT BANK SH.A.
SHËNIME SHOQËRUESE MBI PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017

(Të gjitha shumat shprehen në LEK'000, përveçse kur është shprehur ndryshe)



n) Pronat e marra në zotërim

Pronat e marra në zotërim përbëjnë aktivet jo-financiare të marra në zotërim nga banka për likuidimin e kredive me probleme. Aktive. Aktivet fillimisht njihen me vlerën e drejtë në momentin e marrjes në zotërim dhe përfshihen në zërin e ndërtesave dhe pajisjeve, aktivet e tjera financiare, investime në prona ose tek inventari brenda aktiveve të tjera në varësi të natyrës së tyre dhe qëllimit të Bankës në lidhje me rikuperimin e këtyre pronave dhe më pas rimaten dhe kontabilizohen në përputhje me politikat kontabël për këto kategori të aktiveve.

Pronat e marra në zotërim nga Banka në datën e raportimit kryesisht përfshihet tek inventarët brenda aktiveve të tjera dhe më pas matet me nivelin më të ulët ndërmjet kostos, zakonisht të përcaktuar nga procedurat e ekzekutimit dhe vlerës neto të realizueshme, duke qenë vlera e drejtë e kolateralit të përcaktuar nga vlerësuesit e jashtëm të pavarur, të cilët zotërojnë një kualifikim profesional të njohur dhe të kualifikuar dhe që kanë përvojë në vlerësimin e vendndodhjes dhe kategorisë së ngjashme, minus shpenzime për realizimin e shitjes. Pronat e marra në zotërim që janë rikuperuar qoftë nëpërmjet të ardhurave nga qiraja ose nga vlerësimi i kapitalit përfshihet në investimin për prona. Pronat e luajtshme dhe pronat e paluajtshme me çështjet që kanë të bëjnë me tituj ligjorë nuk njihen si aktiv në momentin e marrjes në zotërim. Çdo humbje që rrjedh nga rivlerësimi i mësipërm regjistrohet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Fitimet ose humbjet nga shllja e këtyre aktiveve njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

o) Detyrime nga institucione të tjera financiare

Shumat e arkëtueshme nga institucionet e tjera financiare regjistrohen në momentin kur Banka i jep para institucioneve financiare homologe pa qëllime tregtimi të arkëtimit jo-derivative të pakuotuar që duhet të paguhet në data të caktuara fikse ose të përcaktueshme. Shumat e arkëtuara nga institucionet e tjera financiare kontabilizohen me koston e amortizuar.

p) Depozitat dhe borxhi i varur

Depozitat dhe borxhet e varura përbëjnë burimet kryesore të financimit të Bankës.

Kur Banka shet një aktiv financiar dhe në të njëjtën kohë nënshkruan një marrëveshje për riblerjen e aktivit (ose të një aktivi të ngjashëm) me çmim fiks në një datë të ardhshme (marrëveshje të shitjes dhe riblerjes) marrëveshja kontabilizohet si depozite, dhe aktivi në fjalë vazhdon të njihet në pasqyrat financiare të Bankës.

Depozitat dhe borxhet e varura fillimisht maten me vlerën e drejtë plus kostot direkte të transaksionit, dhe me pas maten me koston e tyre të amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit.

q) Provizionet

Një provizion mund të njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje në të kaluarën, Banka disponon një detyrim ligjor ose konstruktiv që mund të vlerësohet me besueshmëri dhe që gjithashtu është e mundur që të kërkojë dalje të përfitimeve ekonomike për të mbyllur detyrimin. Provizionet përcaktohen duke përdorur si normë skontimi për flukset e pritshme të parasë në të ardhmen, një normë para taksës e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe aty ku është e përshtatshme, edhe specifikat e riskut për detyrimin. Konvertimi i zbritjes njihet si kosto dhe shpenzim financiar.

2. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

r) Përfitimet e punonjësve

Banka operon vetëm me pagimin e kontribute të detyrueshme të sigurimeve shoqërore të cilat gjenerojnë përfitime pensioni për punonjësit. Autoritetet lokale janë përgjegjës për përcaktimin pragun minimal ligjor për pensionet në Shqipëri sipas një plani të përcaktuar të kontributeve për pension. Kontributet e Bankës në planin e pensionit paraqiten në pasqyrën e të ardhurave në momentin e pagesës.

s) Garancitë financiare dhe angazhimet e huas

Garancitë financiare janë kontrata që kërkojnë që Banka të realizojë pagesa specifike për të rimbursuar mbajtësin e garancisë për një humbje që ka ndodhur si rezultat i mungesës së pagesës sipas termave kontraktuale për një instrument borxhi nga një debitor i caktuar. Angazhimet e huas janë angazhime të qëndrueshme për të ofruar kredi sipas termave dhe kushteve të

Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare duhet të lexohet në lidhje me shënimet të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare që paraqiten nga faqa 8 deri në 64



COSMOS TRANSLATIONS
& EVENTS SH.P.K.
NIPT: L01731002V
Rr. «Andon Zako Çajupi»
P.2014, Sh.Nr.1 Ap.5/6
Tirana - Albania
E-mail: info@cosmos-sh.com
www.cosmos-sh.com

pyj



përcaktuara paraprakisht. Këto angazhime financiare regjistrohen në pasqyrën e pozicionit financiar nëse dhe në momentin kur janë të pagueshme.

Banka lëshon garanci financiare dhe angazhime për të dhënë hua. Garancitë financiare përfaqësojnë siguri të parevokueshme për të bërë pagesa në rast se një klient nuk mund të përmbushë detyrimet e tij ndaj palëve të treta dhe të mbajë të njëjtin rrezik kredie si huat. Garancitë financiare dhe angazhimet për të siguruar një hua fillimisht njihen me vlerën e tyre të drejtë, e cila normalisht evidentohet nga shuma e komisioneve të arkëtuara. Kjo shumë amortizohet në mënyrë lineare gjatë kohëzgjatjes së angazhimit, me përjashtim të angazhimeve për të dhënë kredi të reja, nëse është e mundur që Banka do të hyjë në një marrëveshje specifike të huadhënies dhe nuk parashikon të shesë kredinë që rezulton menjëherë pas dhënies së saj; pagesat e angazhimit të huasë janë shtyrë dhe përfshihen në vlerën kontabël të huasë në momentin e njohjes fillestare. Në fund të çdo periudhe raportimi, angazhimet maten me vlerën më të lartë se (i) gjendja e mbetur e paamortizuar e shumës në momentin e njohjes fillestare dhe (ii) çmuarja më e mirë e shpenzimeve që duhen për të shlyer angazhimin në fund të çdo periudhe raportimi.

Garancitë e kontratës janë kontrata që ofrojnë kompensim nëse një palë tjetër nuk arrin të përmbush një detyrim kontraktual. Kontrata të tilla transferojnë rrezikun jo-financiar të kontratës përveç rrezikut të kredisë. Garancitë e kontratës fillimisht njihen me vlerën e tyre të drejtë, e cila normalisht evidentohet nga shuma e komisioneve të arkëtuara. Kjo shumë amortizohet në mënyrë lineare gjatë kohëzgjatjes së kontratës. Në fund të secilës periudhë raportimi, garancitë e kontratës maten me vlerën më të lartë se: (i) gjendja e paamortizuar e shumës në momentin e njohjes fillestare dhe (ii) çmuarja më e mirë e shpenzimeve që duhen për të zgjidhur kontratën në fund të çdo periudhë raportimi, skontuar në vlerën aktuale. Nëse Banka ka të drejtën kontraktuale për t'u kthyer klientit të saj për rikuperimin e shumave të paguara për të shlyer kontratat e garancisë së ekzekutimit, këto shuma do të njihen si hua dhe të arkëtueshme pas transferimit të kompensimit të humbjes tek përfituesi i garancisë.

t) Provizionet për detyrimet

Provizionet për detyrimet janë detyrime jofinanciare në kohë ose shuma të pasigurta. Ato maturohen kur Banka ka një detyrim aktual ose konstruktiv si rezultat i ngjarjeve të kaluara, ekziston mundësia që një fluks në dalje e burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike të kërkohet për të shlyer detyrimin dhe mund të bëhet një çmuarje e besueshme e shumës së detyrimit.

Taksat dhe detyrimet, të tilla si tatimi përveç tatimit mbi fitimin ose tarifat rregullatore të bazuara në informacionet që lidhen me një periudhë para lindjes së detyrimit për të paguar, njihen si detyrime kur ndodh ngjarja detyruese në bazë të të cilës paguhet taksa, siç parashikohet në legjislacion, e cila sjell detyrimin për të paguar taksën. Nëse një taksë paguhet përpara ngjarjes detyruese, ajo njihet si parapagim.

u) Detyrime tregtare dhe të tjera

Detyrimet tregtare përilogariten në momentin kur kundërpala ka përmbushur detyrimet e saj në bazë të kontratës dhe kontabilizohen me kosto të amortizuara.

v) Kapitali aksionar

(i) Kostot për emetimin e aksioneve

Kostot dhe shpenzimet shtesë që i atribuohen në mënyrë direkte emetimit të aksioneve të reja paraqiten në kapital si një zbritje nga të ardhurat pa tatimin, neto.

ii) Primi i aksioneve

Primi i aksioneve përfaqëson vlerën e kontributeve që arkëtohet mbi vlerën nominale të aksioneve që janë emetuar.

(iii) Dividendët për aksionet e zakonshme

Dividendët për aksionet e zakonshme njihen në kapital për periudhën gjatë të cilës miratohen nga aksionarët e Bankës. Dividendët për periudhën që deklarohen pas datës së raportimit pasqyrohen si ngjarje pas përfundimit të periudhës së raportimit.

Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare duhet të lexohet në lidhje me shënimet të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare që paraqiten nga faqa 8 deri në 64



COSMOS TRANSLATIONS
& EVENTS SH.R.K.

NIPT: L0173100222

Rr. e Andon Zako Çajupit
16/4, Shk. 1, Ag. 5116

Tirana - Albania
E-mail: info@cosmos.al.com
www.cosmos.al.com



3. Standardet e reja, amendimet dhe interpretimet ende të pamiratuara

Miratimi i standardeve të reja ose të rishikuara dhe interpretimet

Standardet e ndryshuara të mëposhtme u bënë efektive për Bankën nga data 1 janar 2017, por nuk kanë patur ndonjë ndikim material në Bankë:

- Iniciativa për dhënie informacionesh shpjeguese - Ndryshime në SNK 7 (publikuar më 29 janar 2016 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas datës 1 janar 2017). Informacionet e reja për publikim përfshihen në Shënimin 15
- Njohja e të drejtave tatimore të shtyra për humbjet e perealizuara - Ndryshimi i SNK 12 (publikuar më 19 janar 2016 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas datës 1 janar 2017)

Ndryshimet në SNRF 12 të përfshira në Përmirësimet Vjetore të Ciklit të SNRF-ve 2014-2016 (publikuar më 8 dhjetor 2016 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas datës 1 janar 2017).

4. Deklarime të reja kontabël

Janë nxjerrë disa standarde dhe interpretime të reja që janë të detyrueshme për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas datës 1 Janar 2017 ose më vonë, dhe të cilat Banka nuk i zbatuar më herët.

SNRF 9 "Instrumentet financiare: Klasifikimi dhe matjet" (i ndryshuar në Korrik 2014 dhe në fuqi për periudhat që fillojnë në ose pas datës 1 Janar 2018). Tiparet kryesore të standardit të ri janë:

- Aktivët financiarë duhet të klasifikohen në tri kategori të matjes: aktivët financiarë që duhet të maten më pas me koston e amortizuar, aktivët financiarë që maten më pas me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera përmbledhëse (FVPL) dhe aktivët financiarë që maten më pas me vlerën e drejtë nëpërmjet pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve.
- Klasifikimi për instrumentet e borxhit nxitet nga modeli i biznesit të subjektit për menaxhimin e aktiveve financiare dhe nëse flukset monetare kontraktuale përfaqësojnë vetëm pagesat e principalit dhe interesit (SPPI). Nëse një instrument borxhi mbahet për tu arkëtuar, ai mund të kontabilizohet me koston e amortizuar nëse plotëson edhe kërkesat SPPI. Instrumentet e borxhit që plotësojnë kërkesat e SPPI që mbahen në një portofol ku një subjekt i mban për të arkëtuar flukse të parasë dhe i shet aktivet mund të klasifikohet me vlerë të drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera përmbledhëse. Aktivët financiarë që nuk përmbajnë flukse monetare që janë vetëm pagesat e principalit dhe interesit duhet të maten me vlerën e drejtë përmes pasqyrave të të ardhurave dhe shpenzimeve (për shembull, derivatet). Derivatët e përfshirë nuk ndahen më nga aktivët financiarë, por do të përfshihen në vlerësimin e kushteve të SPPI (vetëm pagesat e principalit dhe interesit).
- Pjesa më e madhe e kërkesave të SNK 39 për klasifikimin dhe matjen e detyrimeve financiare janë bartur të pandryshuara në SNRF 9. Ndryshimi kryesor është që një subjekt duhet të paraqesë efektet e ndryshimeve në rrezikun e vet të kredisë për detyrimet financiare të përcaktuara me vlerën e drejtë nëpërmjet pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve tek të ardhurat e tjera përmbledhëse.
- SNRF 9 paraqet një model të ri për njohjen e humbjeve nga zhvlerësimi - modeli për humbjet e parashikuara nga kreditë. Ekziston një metodë me "tre faze" e cila bazohet në ndryshimin në cilësinë e kredisë të aktiveve financiare që nga njohja fillestare. Në praktikë, rregullat e reja nënkuptojnë se subjektet duhet të regjistrojnë një humbje të menjëhershme të barabartë me vlerën sipas metodës për humbjet e parashikuara nga kreditë ECL për 12 muaj për njohjen fillestare të aktiveve financiare që nuk janë të zhvlerësuara nga kredia (ose ECL gjatë jetës për të arkëtueshmet tregtare). Nëse ka një rritje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë, zhvlerësimi matet duke përdorur metodën për humbjet e parashikuara nga kreditë (ECL) për gjithë jetëgjatësinë në vend të metodës ECL për 12 muaj. Modeli përfshin thjeshtimet operationale për qiranë dhe llogaritë e arkëtueshme tregtare.

Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare duhet të lexohet në lidhje me shënimet të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare që paraqiten nga faqa 8 deri në 64




COSMOS TRANSLATIONS
& EVENTS S.P.A.

NIP: 001731001V

Rr. Adon Zako Çajupi
P. 204, Shk. 1, Ap. 5/6
Tirana - Shqipëri
E-mail: info@cosmos.com
www.cosmos.com

PROCREDIT BANK SH.A.
SHËNIME SHOQËRUESE MBI PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017

(Të gjitha shumat shprehen në LEK'000, përveçse kur është shprehur ndryshe)



- Kërkesat e kontabilitetit për mbrojtjen u ndryshuan për të harmonizuar kontabilitetin me afër me administrimin e rrezikut. Standardi u ofron subjekteve një zgjedhje në politikën kontabël ndërmjet zbatimit të kërkesave të kontabilitetit mbrojtës të SNRF 9 dhe vazhdimit të zbatimit të SNK 39 në të gjitha fondet mbrojtëse sepse standardi aktualisht nuk trajton kontabilizimin për mbrojtjet makro.


SNRF 9 "Instrumentet Financiare" do të ketë një ndikim në njohjen dhe matjen, zhvlerësimin si dhe në kërkesat për dhënien e informacioneve shpjeguese të instrumenteve financiare. Banka nuk parashikon që kërkesat e reja të klasifikimit të kenë një ndikim material. Bazuar në vlerësimin paraprak, zbatimi i kërkesave për zhvlerësim të SNRF 9 parashikohet të sjellë një rritje të nivelit të provigjionit për humbjet në momentin e tranzicionit dhe rritje të moderuar të shpenzimeve për provigjionimin e humbjeve nga huatë dhe paradhëniet. Kërkesat e reja të kontabilitetit të mbrojtjes nuk do të ndikojnë në pasqyrat financiare pasi Banka nuk zbaton kontabilitetin mbrojtës. SNRF 9 është i zbatueshëm për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas datës 1 janar 2018.



Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare duhet të lexohet në lidhje me shënimet të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare që paraqiten nga faqa 8 deri në 64

COSMOS TRANSLATIONS
& EVENTS SH.P.K.
NIPT: L01718002V
Rr. «Andon Zako Çajupi»
P.20/4, Shk.1, Ap.5/6
Tirana - Albania
E-mail: info@cosmos-at.com
www.cosmos-at.com

M/S



4. Deklarime të reja kontabël (vazhdim)

Drejtimi i Bankës ka ndërmarrë projektin për zbatimin e standardit SNRF 9 i cili është duke u zhvilluar nën mbikëqyrjen e Grupit ProCredit Holding dhe në përputhje me parimet e lartpërmendura të zbatueshme në të gjithë Grupin. Bazuar në llogaritjet paraprake dhe analizat e kryera nga data e përgatitjes së këtyre pasqyrave financiare, rregullimi total i parashikuar i adoptimit të SNRF 9 në bilancin fillestar të fitimit të pashpërndarë të Bankës nga vitet e mëparshme në 1 janar 2018 është afërsisht 4,149 mijë Euro, duke përfaqësuar një reduktim të lidhur kryesisht me rritjen e provizioneve për humbjet sipas SNRF 9 në krahasim me provizionet për humbjet nga kreditë sipas SNK 39 (duke përfshirë provizionet për ekspozimet jashtë bilancit të trajtuara sipas SNK 37).

Nuk parashikohen ndryshime të rëndësishme për detyrimet financiare, përveç ndryshimeve në vlerën e drejtë të detyrimeve financiare të përcaktuara në FVTPL që i atribuohen ndryshimeve në rrezikun e kredisë të instrumentit, të cilat do të paraqiten në të ardhurat e tjera përmbledhëse

Standardi i ri gjithashtu paraqet kërkesat e zgjeruara të publikimit të informacionit dhe ndryshimet në prezantim. Këto kërkesa parashikohen të ndryshojnë natyrën dhe shkallën e dhënies së informacioneve shpjeguese të Bankës për instrumentet e saj financiare veçanërisht në vitin e miratimit dhe adoptimit të standardit të ri.

SNRF 15, Të ardhurat nga Kontratat me Klientët (publikuar në 28 maj 2014 dhe në fuqi për periudhat që fillojnë në ose pas datës 1 janar 2018). Standardi i ri prezanton parimin kryesor që të ardhurat duhet të njihen kur mallrat ose shërbimet i transferohen klientit, me çmimin e transaksionit. Çdo mall ose shërbim në grup që është i dallueshëm duhet të njihet veçmas dhe çdo zbritje ose skonto në çmimin e kontratës në përgjithësi duhet të ndahet për elementët e veçantë. Nëse pagesa ndryshon për çfarëdo arsye, shumat minimale duhet të njihen nëse nuk janë në rrezik të madh për anulimin. Kostot dhe shpenzimet që kryhen për të siguruar kontrata me klientët duhet të kapitalizohen dhe të amortizohen gjatë periudhës kur konsumohen përfundimisht nga kontrata. Standardi i ri nuk parashikohet të ketë një ndikim material në pasqyrat financiare të Bankës.

Ndryshimet në SNRF 15, Të hyrat nga Kontratat me Klientët (publikuar më 12 prill 2016 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas datës 1 janar 2018). Ndryshimet nuk ndryshojnë parimet themelore të Standardit, por sqarojnë se si duhet të zbatohen këto parime. Amendimet sqarojnë se si të identifikojnë një detyrim për zbatim (premtimi për të transferuar një të mirë ose një shërbim tek klienti) në një kontratë; si të përcaktohet nëse një kompani është një aktor kryesor (ofruesi i një të mirë ose shërbimi) ose një agjent (përgjegjës për rregullimin e të mirave ose shërbimeve që duhet të ofrohen); dhe si të përcaktohet nëse të ardhurat nga dhënia e licencës duhet të njihen në një moment ose me kalimin e kohës. Përveç sqarimeve, ndryshimet përfshijnë dy lehtësime shtesë për të zvogëluar koston dhe kompleksitetin për një kompani në momentin e zbatimit për herë të parë të standardit të ri. Amendimi i ri nuk parashikohet të ketë një ndikim material në pasqyrat financiare të Bankës.

SNRF 16, Qiratë (publikuar më 13 janar 2016 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas datës 1 Janar 2019). Standardi i ri përcakton parimet për njohjen, matjen, prezantimin dhe zbulimin e qirasë. Të gjitha qiratë financiare rezultojnë që qiramarrësi të ketë të drejtën e përdorimit të një aktivi në fillim të qirasë dhe nëse pagesat e qirasë bëhen me kalimin e kohës, gjithashtu marrin financim. Prandaj, SNRF 16 eliminon klasifikimin e qirasë si qira operative ose qira financiare siç kërkohet në bazë të SNK 17 dhe, në vend të saj, prezanton një model të vetëm të kontabilitetit të qiramarrësit. Qiramarrësit duhet të njohin: (a) aktivet dhe detyrimet për të gjitha qiratë me një afat më të gjatë se 12 muaj, përveç rastit kur aktivi në fjalë ka një vlerë të vogël; dhe (b) zhvlerësimin e aktiveve të qirasë të ndarë më vete nga interesi për detyrimet e qirasë në pasqyrën e të ardhurave. SNRF 16 në thelb parashikon më tej kërkesat e kontabilizimit për qiradhënësit në SNK 17.

Si rrjedhojë, një qiradhënësi vazhdon të klasifikojë qiratë e tij si qira operative ose qira financiare dhe të kontabilizojë ndryshe këto dy lloje të qirasë. Banka po vlerëson aktualisht ndikimin e standardit të ri në pasqyrat financiare të saj.

Iniciativa për dhënie dhe publikimin e informacioneve shpjeguese - Ndryshime në SNK 7 (i publikuar më 29 janar 2016 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 janarit 2017). SNK 7 i ndryshuar do të parashikojë dhënie dhe publikimin e informacioneve shpjeguese mbi rakordimin e lëvizjeve në detyrimet që rezultojnë nga aktivitetet e financimit. Banka do të paraqesë këtë informacion në pasqyrat financiare të vitit 2017.

Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare duhet të lexohet në lidhje me shënimet të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare që paraqiten nga faqa 8 deri në 64

PROCREDIT BANK SH.A.
SHËNIME SHOQËRUESE MBI PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017
(Të gjitha shumat shprehen në LEK'000, përveçse kur është shprehur ndryshe)



SNRF 17 "Kontratat e Sigurimeve" (publikuar në 18 maj 2017 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas datës 1 janar 2021). SNRF 17 zëvendëson SNRF 4, i cili i parashikon për kompanitë lëshime që të kryejnë kontabilizimin e kontratave të sigurimit duke përdorur praktikat ekzistuese. Rrjedhimisht, ishte e vështirë për investitorët të krahasojnë dhe dallojnë ndryshimin e performancës financiare të kompanive të ngjashme të sigurimit. SNRF 17 është një standard i bazuar në një parim të vetëm për kontabilizimin e të gjitha llojeve të kontratave të sigurimit, duke përfshirë kontratat e risigurimit të siguruesit. Standardi i ri nuk parashikohet të ketë një ndikim material në pasqyrat financiare të Bankës.

Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare duhet të lexohet në lidhje me shënimet të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare që paraqiten nga faqa 8 deri në 64



COSMOS TRANSLATE
& EVENTS SH.P.K.

NIPT: L01731002V

20 Andon Zako Çajupri
P.20/II, Shk.1, Ap.5/5
Tirana, Shqipëri
mail: info@cosmos.al
www.cosmos.al.com



4. Deklarime të reja kontabël (vazhdim)

KIRFN 22 "Transaksione në valutë të huaj dhe parapagimi " (publikuar në 8 dhjetor 2016 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas datës 1 janar 2018.) Ky interpretim vlerëson mënyrën e përcaktimit të datës së transaksionit gjatë zbatimit të standardit për transaksionet në monedhë të huaj, SNK 21. Interpretimi zbatohet kur një subjekt paguan ose ka marrë parapagim paraprakisht për kontratat në monedhë të huaj. Interpretimi specifikon që data e transaksionit është data në të cilën njëësia ekonomike fillimisht njihet aktivin jo-monetar ose detyrimin jomonetar që nga pagesa ose marrja e shumës paraprake. Nëse ka pagesa të shumëfishta ose faturat paraprakisht, Interpretimi parashikon që një subjekt duhet të përcaktojë datën e transaksionit për secilën pagesë ose marrje të parapagimit. Standardi i ri nuk parashikohet të ketë një ndikim material në pasqyrat financiare të Bankës.

KIRFN 23 "Pasiguria mbi Trajtimin e Tatimit mbi Fitimin" (publikuar në 7 qershor 2017 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas datës 1 janar 2019). SNK 12 specifikon mënyrën e kontabilizimit të tatimit aktual dhe të drejtave tatimore të shtyra, por jo si të reflektojë dhe pasqyrojë efektet e pasigurisë. Interpretimi sqaron mënyrën e zbatimit të kërkesave njohjes dhe të matjes në SNK 12 nëse ka pasiguri në lidhje me trajtimin e tatimit mbi fitim. Një subjekt duhet të përcaktojë nëse duhet të shqyrtojë çdo trajtim tatimor të pasigurt të ndarë më vete ose së bashku me një ose më shumë trajtime të tjera të pasigurta tatimore bazuar në metodën më të mirë që parashikon zgjidhjen e pasigurisë. Subjekti duhet të supozojë se autoriteti tatimor do të shqyrtojë shumat që ka të drejtë të ekzaminojë dhe të ketë njohuri të plotë për të gjitha informacionet e lidhura me to gjatë kryerjes së këtyre ekzaminimeve. Nëse subjekti arrin në përfundimin se nuk është e mundur që autoriteti tatimor të pranojë një trajtim tatimor të pasigurt, efekti i pasigurisë do të pasqyrohet në përcaktimin e fitimit ose humbjes së tatueshme, bazave tatimore, humbjeve tatimore të papërdorura, kredive të papërdorura tatimore ose normave tatimore, duke përdorur ose shumën më të mundshme ose vlerën e pritur, në varësi të metodës që subjekti pret të parashikojë më mirë zgjidhjen e pasigurisë. Subjekti do të pasqyrojë efektin e një ndryshimi në fakte dhe rrethana ose në informacione të reja që ndikojnë në gjykimet ose vlerësimet e parashikuara nga interpretimi si një ndryshim në çmuarjet kontabël. Shembujt e ndryshimeve në fakte dhe rrethana ose informacione të reja që mund të rezultojnë në rërvlerësimin e një gjykimi apo vlerësimi përfshijnë, por nuk kufizohen në, ekzaminimet ose veprimet e një autoriteti tatimor, ndryshimet në rregullat e vendosura nga një autoritet tatimor ose përfundimi i një të drejte të autoritetit tatimor për të shqyrtuar ose kontrolluar trajtimin tatimor dhe fiskal. Mungesa e një marrëveshjeje ose mosdakordësia me autoritetin tatimor në lidhje me një trajtim tatimor dhe fiskal, në mënyrë të izoluar, nuk ka të ngjarë të ndryshojë fakte dhe rrethana apo të sjellë informacione të reja që ndikojnë në gjykimet dhe çmuarjet e parashikuara në bazë të interpretimit. Standardi i ri nuk parashikohet të ketë një ndikim material në pasqyrat financiare të Bankës.

Standardet e reja të tjera që vijojnë më poshtë nuk parashikohen të kenë ndonjë ndikim material; në bankë pas adoptimit dhe zbatimit të tyre:

- Shitja ose Kontributi i Aktiveve midis një Investitori dhe Bashkëpunëtorit të tij ose Sipërmarrje të Përbashkët - Ndryshimet në SNRF 10 dhe SNK 28 (të publikuara në 11 Shtator 2014 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas një date të caktuar që do të përcaktohet nga BSNK).
- Njohja e të drejtave tatimore të shtyra për humbjet e përealizuara - Ndryshimet në SNK 12 (i publikuar në 19 janar 2016 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2017).
- Ndryshimet në SNRF 2, Pagesa e bazuar në aksione (publikuar në 20 qershor 2016 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas datës 1 janar 2018).
- Zbatimi i SNRF 9 Instrumentet Financiare me SNRF 4 Kontratat e Sigurimeve - Ndryshimet në SNRF 4 (të publikuara në 12 Shtator 2016 dhe në fuqi, në varësi nga qasja, për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 datës Janar 2018 për subjektet që zgjedhin të zbatojnë opsionin e përjashtimit të përkohshëm; kur subjekti zbaton për herë të parë SNRF 9 për subjekte që zgjedhin të zbatojnë metodën e mbivendosjes).
- Përmirësimet vjetore të ciklit të SNRF 2014-2016 (të publikuara në 8 Dhjetor 2016 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas datës 1 Janar 2017 për ndryshimet e SNRF 12 dhe në ose pas datës 1 Janar 2018 për ndryshimet në SNRF 1 dhe SNK 28).
- KIRFN 22 - Transaksionet në monedhë të huaj dhe parapagimet (publikuar në 8 dhjetor 2016 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas datës 1 janar 2018) do të kenë një ndikim të vogël në pasqyrat financiare. Interpretimi është në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas datës 1 janar 2018.

Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare duhet të lexohet në lidhje me shënimet të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare që paraqiten nga faqa 8 deri në 64



COSMOS TRANSLATIONS & EVENTS SH.P.K.

NIPT: L01731002V

Pr "Andrea Zako Çajupi"
P.2017, Shk.1, Ap.505
Tirana - ALBANI
mail: info@cosmos.com.al
www.cosmos.com.al

PROCREDIT BANK SH.A.
SHËNIME SHOQËRUESE MBI PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017

(Të gjitha shumat shprehen në LEK'000, përveçse kur është shprehur ndryshe)

- Transferimet e investimeve në prona - Ndryshimet në SNK 40 (publikuar në 8 dhjetor 2016 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas datës 1 janar 2018).

Nëse nuk është përshkruar ndryshe, standardet dhe interpretimet e reja nuk parashikohen të ndikojnë ndjeshëm në pasqyrat financiare të Bankës.

Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare duhet të lexohet në lidhje me shënimet të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare që paraqiten nga faqa 8 deri në 64


COSMOS TRANSLAT
& EVENTS SH.P.

NIFIT: L0173107

22

Artur Zake
2014, Str. 1, A
Tirana - Alb
info@cosmos
www.cosmos

Zake



5. Përmbledhjet e gjykimeve kontabël të rëndësishme dhe burimet kryesore të pasigurisë së çmuarjeve

Banka bën gjykimet, çmuarjet dhe supozimet të cilat prekin shumat e raportuara të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit ushtrimit pasardhës. Gjykimet dhe çmuarjet vlerësohen në mënyrë të vazhdueshme dhe në bazë të eksperiencës historike dhe faktorëve të tjerë, duke përfshirë pritshmëritë e ngjarjeve të ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në varësi të rrethanave.

Drejtimi i bankës gjithashtu bën gjykime të caktuara, përveç atyre që përfshijnë çmuarje, në procesin e zbatimit të politikave kontabël. Gjykimet që kanë efektin më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare dhe vlerësimet që mund të shkaktojnë një rregullim domethënës në vlerën kontabël të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar përfshijnë:

(i) Zhvlerësimi për humbjet nga kreditë

Banka rishikon portofolin e saj të kredisë për të vlerësuar zhvlerësimin të paktë çdo tremujor. Për të përcaktuar nëse humbja nga zhvlerësimi duhet të regjistrohet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, Banka bën gjykimet nëse ekzistojnë të dhëna të vëzhgueshme dhe evidentueshme të cilat tregojnë se ka një rënie të matshme në fluksin e ardhshëm të parasë së parashikuar nga portofoli i kredisë përpara se rënia mund të identifikohet me një hua individuale të atij portofoli. Ky fakt mund të përfshijë të dhëna të vëzhgueshme dhe evidentueshme të cilat tregojnë se ka patur një ndryshim të pafavorshëm në statusin e pagimit të huamarrësve në një grup, ose në kushtet ekonomike kombëtare ose lokale të cilat lidhen me mospagesat për aktivet në Bankë.

Drejtimi i Bankës përdor çmuarjet në bazë të eksperiencës së humbjeve historike për aktive me karakteristika të riskut të kredisë dhe fakte objektive të zhvlerësimit të ngjashëm me kreditë e portofolit gjatë planifikimit të fluksit të ardhshëm të parasë. Metodologjia dhe supozimet që përdoren për të vlerësuar shumën dhe kohën e fluksit të ardhshëm të parasë rishikohen rregullisht për të zvogëluar diferencat midis çmuarjeve të humbjes dhe eksperiencës së humbjeve aktuale.

(ii) Kolaterali i marr në pronësi


Për të përcaktuar vlerën neto të realizueshme për kolateralin dhe pronat e rimarra në zotërim që përfshihen në inventarët brenda aktiveve të tjera, Banka përcakton matjen e vlerës së drejtë bazuar në raportet e vlerësuesve të jashtëm të pavarur të pronave, që kanë kualifikime profesionale dhe statutoare. Drejtimi i Bankës ka shqyrtuar supozimet e vlerësuesve që bazohen në modelet e flukseve të parasë të skontuara që janë përdorur në vlerësim dhe konfirmon faktorët si pronat e ngjashme dhe / ose transaksionet e ngjashme, norma e skontimit të aplikuar janë përcaktuar në mënyrë të përshtatshme në bazë të të dhënave dhe supozimeve të përdorura dhe duke vlerësuar kushtet e tregut në fund të periudhës së raportimit. Pavarësisht nga sa më sipër, drejtimi i bankës konsideron se vlerësimi i kolateralit të saj të marrë në pronësi aktualisht është subjekt i një shkalle më të lartë të gjykimit dhe një rritje e mundësisë që të ardhurat reale në një shtjje mund të ndryshojnë nga vlera kontabël.

(iv) Njohja e të drejtave tatimore të shtyra të tatimit mbi fitim.

Njohja e të drejtave tatimore të shtyra për tatimin mbi fitimin përfaqëson tatimin mbi fitimin të rikuperueshme nëpërmjet zbritjeve të ardhshme nga fitimet e tatuueshme dhe regjistrohen në pasqyrën e pozicionit financiar. Të drejtat tatimore të shtyra për tatimin mbi fitimin regjistrohen në masën e mundshme të realizimi i përfilimit tatimor. Fitimet e tatuueshme të ardhshme dhe shumat e përfitimeve tatimore që janë të mundshme në të ardhmen, bazohen në një plan biznesi afatmesëm të përgatitur nga drejtimi i bankës dhe rezultatet pasuese në vijim. Plani i biznesit bazohet në pritshmëritë e drejtimit të bankës që besohet të jenë të arsyeshme sipas rrethanave. Megjithatë, ai varet edhe nga zhvillimet e ardhshme të cilat nuk janë të sigurt.



Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare duhet të lexohet në lidhje me shënimet të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare që paraqiten nga faqa 8 deri në 64



6. Administrimi i riskut financiar

Në aktivitetin normal të biznesit të saj, Banka është e ekspozuar ndaj një numri rreziqesh dhe këto aktivitete përfshijnë analizën, vlerësimin, pranimin dhe menaxhimin e disa niveleve të riskut ose kombinimin e rreziqeve. Ndërmarrja e riskut është thelbësore për aktivitetin e biznesit financiar dhe rreziqet operacionale janë një pasojë e paevitueshme e zhvillimit të biznesit. Qëllimi i bankës është të arrijë një ekuilibër dhe balancë të përshtatshme midis riskut dhe përfitueshmërisë si dhe të minimizojë efektet e mundshme të pafavorshme në ecurinë financiare të bankës.

Politikat e bankës për administrimin e riskut janë hartuar në funksion të identifikimit dhe analizës së këtyre rreziqeve, përcaktimit të limiteve dhe kontrolleve të përshtatshme të riskut, për të monitoruar rreziqet dhe respektimin e limiteve nëpërmjet sistemeve informatike të besueshme dhe të përditësuara. Banka rishikon në mënyrë sistematike politikën dhe sistemet për administrimin e riskut për të pasqyruar ndryshimet në tregje, produkte dhe zhvillimin e praktikës më të mirë.

(a) Risku i kredisë

Banka ekspozohet ndaj riskut të kredisë, i cili është risku që si pasojë e mospërbushjes së detyrimeve të kundërpalës, Banka do të pësojë humbje financiare. Risku i kredisë është risku më i rëndësishëm për aktivitetin e biznesit të bankës, për rrjedhojë drejtimi i bankës administrohet me kujdes ekspozimin ndaj riskut të kredisë. Ekspozimet e kredisë linden kryesisht në aktivitetin e kredi-dhënies të cilat përfshijnë hua dhe paradhënie, dhe aktivitete investimi të cilat sjellin depozita dhe letra me vlerë të borxhit në portofolin e aktiveve të bankës.

Risku i kredisë ekziston gjithashtu në instrumentet financiare jashtë bilancit si letër kredi, garanci dhe angazhime kredie. Administrimi dhe kontrolli i riskut të kredisë për hua dhe paradhënie janë përqendruar në Departamentin e Administrimit të Riskut, ndërsa risku ndërbankar për depozitat dhe letrat me vlerë të borxhit janë përqendruar në Departamentin e Thesarit dhe Departamentin e Administrimit të Riskut.


Të gjitha departamentet që janë përgjegjës për administrimin dhe kontrollin e riskut të kredisë, raportojnë rregullisht në Këshillin Administrativ dhe në Këshillin Drejtues.

Tabelat e mëposhtme paraqesin informacion në lidhje me cilësinë e kredisë të aktiveve financiare dhe provigjionin për humbjen nga zhvlerësimi të mbajtura nga Banka kundrejt këtyre aktiveve.

Tabela në vijim paraqet skenarin e rastit më të keq të ekspozimeve ndaj rrezikut të kredisë të Bankës më 31 Dhjetor 2017 dhe 2016, pa marrë në konsideratë asnjë kolateral të mbajtur ose përmirësime të tjera të kredisë bashkëlidhur. Për aktivitetet financiare, ekspozimet e paraqitura më poshtë paraqesin vlerën kontabël neto të raportuar në pasqyrën e pozicionit financiar.



Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare duhet të lexohet në lidhje me shënimet të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare që paraqiten nga faqa 8 deri në 64



6. Administrimi i riskut financiar (vazhdim)

Ekspozimi maksimal ndaj riskut të kredisë

Ekspozimet e riskut të kredisë për aktivet e bilancit paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Mjetet monetare dhe llogari me Bankën Qendrore	5,736,909	4,511,897
Hua dhe paradhënie bankave dhe institucioneve të tjera financiare	119,326	1,238,954
<i>Hua dhe paradhënie klientëve:</i>		
Tregti – biznesi	9,610,584	8,097,851
Bujqësi – biznesi	1,719,490	1,710,806
Prodhim – biznesi	5,133,984	3,678,151
Transporti – biznesi	629,136	476,876
Të tjera – biznesi	3,589,533	3,459,091
Strehim – privat	1,908,480	2,172,211
Investime – private	85,153	107,338
Të tjera – private	102,671	192,127
	22,779,031	19,894,451
Instrumente financiare letra me vlerë të vendosjes	1,831,349	2,870,306
Aktive të tjera financiare	172,818	326,340
<i>Ekspozimet e riskut të kredisë për aktivet jashtë bilancit paraqiten si më poshtë vijon:</i>		
Angazhimet e huas dhe detyrime të tjera të lidhura të kredisë	2,426,117	2,092,347
Garanci financiare	910,067	511,360
Totali	33,975,617	31,445,655

<i>Jashtë bilancit</i>	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Angazhime huaje	2,426,117	2,092,346
Garanci financiare	745,117	511,360
Letër kredi	164,950	-
Provizione të njohura si detyrime	(5,299)	(5,161)
Totali	3,330,885	2,598,545

Banka përcakton rrezikun e kredisë nga ekspozimet e kredive të klientëve si rrezik i humbjeve për shkak të një mos përmbushjeje të mundshme të detyrimeve kontraktuale për pagesat që lidhen me ekspozimin e kredisë së klientit.

Administrimi i rrezikut të kredisë nga ekspozimet e kredive të klientëve bazohet në implementimin e plotë të parimeve të kreditimit nga ana e bankës:

- analiza intensive e kapacitetit të klientëve të bankës për të marrë hua
- dokumentim i kujdesshëm i vlerësimeve të rrezikut të kredisë, duke siguruar që analiza e kryer të kuptohet nga palët e treta
- shmangle strikte e kreditimit të tepërt të klientëve
- ndërtimi i marrëdhënieve personale dhe afat-gjata me klientin dhe ruajtja e një kontakti të rregullt
- monitorimi nga afër i ripagimeve dhe treguesve të paralajmërimit të hershëm
- aplikimi dhe zbatimi i menaxhimit të vonesave të vogla
- ekzekutimi i kolateralit në rastin e ngjarjes shkakësore të mospagimit të kredisë
- investimi në punonjës të trajnuar mirë dhe shumë të motivuar
- implementimi dhe zbatimi i proceseve të krijuara me kujdes dhe të dokumentuara mirë
- zbatimi me rigorozitet të parimit të "kontrollit të dyfishtë"

Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare duhet të lexohet në lidhje me shënimet të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare që paraqiten nga faqa 8 deri në 64



COSMOS TRANSLATIO
& EVENTS SH.P.K.

NIPT: L01731002V/
25


Rr. Andon Zako Çajupi

P.2004, Shkollor, Ap. 6/5

Tiranë - (021) 411111

E-mail: info@cosmos-at.com

www.cosmos-at.com



6. Administrimi i riskut financiar (vazhdim)

Diferencimi midis ekspozimeve individuale të rëndësishme dhe të parëndësishme të kredisë të orienton drejt proceseve të dallueshme kreditimi për lloje të ndryshme të ekspozimeve të kredisë - procese që kanë demonstruar në të kaluarën se sigurojnë një menaxhim efektiv të rrezikut të kredisë. Proceset dallohen kryesisht në drejtim të ndarjes së detyrave, të cilat zbatohen plotësisht për ekspozimet individuale të rëndësishme të kredisë që janë relevante ndaj rrezikut dhe një specializim për ekspozimet individuale të rëndësishme që nuk janë relevante ndaj rrezikut të kredisë. Për ekspozimet individuale të rëndësishme të kredisë, pika fillestare e analizës është informacioni i mbledhur nga klienti, duke filluar nga pasqyrat financiare të audituara deri tek vetëdeklarimet

Kriteret kryesore për vendimet e ekspozimit ndaj kredisë bazohen në gjendjen financiare të klientit; në veçanti për ekspozimet individuale të parëndësishme të kredisë, të plotësuara me një rishikim të fondeve likuide dhe vlerësimin e besueshmërisë së klientit. Së fundi, kërkesat e kolateralit janë përgjithësisht më të larta për ekspozimet individuale të kredive. Si rregull i përgjithshëm, sa më e ulët të jetë ekspozimi i kreditit, aq më i mbështetës është dokumentacioni i ofruar nga klienti, aq më e shkurtër është afati i ekspozimit të kredisë, sa më i gjatë historiku i klientit me bankën dhe sa më e lartë të jetë qarkullimi i klientit me bankën, më e ulët do të jenë kërkesat e kolateralit.

Procesi i vendimmarrjes siguron që të gjitha vendimet e kredisë për ekspozimet individualisht të rëndësishme merren nga komiteti i kredisë. Si parim i përgjithshëm, ne e konsiderojmë atë shumë të rëndësishme për të siguruar që biznesi ynë i huadhënies realizohet në bazë të udhëzimeve organizative që parashikojnë rregulla të përshtatshme që rregullojnë strukturat organizative dhe procedurat operative; përshkrimet e punës që përcaktojnë detyrat përkatëse; një ndarje të qartë të autoritetit vendimmarrës; dhe një përcaktim të qartë të përgjegjësisë.

